



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:  
“Administrim Biznesi” me profile: “Menaxhim Marketingu”,  
“Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”  
Universiteti European i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Ana Kapaj**

**Dr. Erida Elmazi**

**Maj / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”,**  
**“Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Administrim Biznesi” me profile: “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.74, dt. 21.01.2009, Diplomë e Nivelit të Dytë
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati me Nr. 07 Prot, datë 14.06.2018 Miratuar nga MASR me shkresën Nr. 8244 / 2 Prot, datë 12.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 21, datë 11.05.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)

17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	<p><b><u>Viti akademik 2021-2022</u></b></p> <p>Menaxhim Marketingu 26 studentë  Administrim Publik 10 studentë  Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh 25 studentë</p> <p><b><u>Viti akademik 2022-2023</u></b></p> <p>Menaxhim Marketingu 25 studentë  Administrim Publik 8 studentë  Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh 24 studentë</p>
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 3 (tre) profile

\* Emërtimi i programit të studimit është me 5 (pesë) profile, por UET nëpërmjet shkresës me Nr.42/1Prot, datë 02.11.2022, kërkon akreditim vetëm për 3 (tre) profilet që janë aktive, profilet “Administrim Territori” dhe “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, nuk janë pjesë e këtij vlerësimi.

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” me kohëzgjatje 2 vite, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licencuar si Fakulteti Ekonomik me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018, pranë Universitetit Europian të Tiranës.

Ky program është licensuar për herë të parë në vitin 2009, sipas VKM Nr.74, dt. 21.01.2009, si Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) me 3 profile: Biznes Marketing, Administrim Publik, Ekonomi Europiane, dhe është akredituar për herë të parë në vitin 2011 me Urdhër të MASH Nr.68, dt. 14.02.2011. Akreditimi i dytë periodik i programit u bë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.21, datë 21.05.2018. Që prej vitit akademik 2018-2019 ky program pësoi disa ndryshime dhe u ofrua me profilet: Menaxhim Marketingu, Administrim Publik, Administrim Territori, Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh, dhe Kontabilitet dhe Raportim Financiar, por disa profile u mbyllën me Vendim Senati nr. 11, datë 26.03.2021 për shkak të numrit të vogël të studentëve që patën interes.

Në bazë të Shkresës Nr.42/1Prot, datë 02.11.2022, drejtuar Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, UET ka kërkuar akreditimin e programit vetem për 3 (tre) profilet aktive të tij, konkretisht: Menaxhim Marketingu, Administrim Publik dhe Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi” me një nga profilet përkatëse.

Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë profesionistë dhe menaxherë të aftë për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës, në drejtim të menaxhimit strategjik të biznesit dhe maksimizimit të fitimit, pavarësisht dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në mjedisin e biznesit. Gjithashtu ky program synon të integrojë njohuritë teorike me dijet aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes sa më të mirë të kërkesave të tregut. Përmes ofrimit të këtij program studimi synohet të ndërmjetësohen marrëdhëniet e studentëve me tregun e punës, duke rritur kështu potencialin e tyre për punësim dhe karrierë në fushën e biznesit.

#### **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” ofruar nga Institucioni i Arsimin të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”, filloi me caktimin nga ASCAL si ekspertë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) të eksperteve: Prof. Dr. Ana Kapaj dhe Dr. Erida Elmazi. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesja e ASCAL Znj. Majlinda Demireli.

Ekspertët e jashtëm u njohën paraprakisht me dokumentacionin e dërguar nga Institucioni. Më tej, procedura vijoi me trajnimin pranë ASCAL mbi parimet dhe procedurat e procesit të vlerësimit, ndarjen e punës dhe dakortësimin e grupit mbi datat e zhvillimit të vizitës në institucion. Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, ekspertët filluan shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL. Vizita 2 ditore në Universitetin Europian të Tiranës, u realizua gjatë datave 28-29.09.2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u prit nga Koordinatori Teknik, si edhe u takua me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, si njësia kryesore dhe Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si njësia bazë që ofron këtë program studimesh, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik efektiv dhe të angazhuar me kontratë në këtë program studimi, personelin ndihmës administrativ (nga Zyra për Zhvillimin e Projekteve dhe Partneriteteve; Drejtorja e

Standardeve dhe Cilësisë; Zyra e Burimeve Njerëzore; Sekretaria mësimore; Këshillimi i Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit), si dhe studentët e këtij programi studimi. Gjatë kësaj vizite GVJ realizoi vëzhgime të mjediseve dhe infrastrukturës në funksion të mbarëvajtjes së zhvillimit të procesit mësimor të këtij programi studimi. U zhvilluan vëzhgime pranë Sekretarisë Mësimore, bibliotekës, auditorëve si dhe mjediseve të zhvillimit të veprimtarive mbështetëse ndaj studentëve. Gjatë takimeve të realizuara u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse. GVJ gjithashtu kërkoi dokumentacion shtesë i cili u vu në dispozicion në sistemin e ASCAL dedikuar procedurës lidhur me këtë program studimi.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Kordinatori Teknik i ASCAL. Ky raport pasqyron vlerësimin e në lidhje me plotësimin e kitereve dhe standardeve që i referohen këtij program studimi bazuar në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL si dhe vizitës së realizuar në institucion.

Universiteti European i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 21.03.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 40 / 11 Prot, datë 21.03.2024. Universiteti European i Tiranës njofton në ASCAL më datë 17.04.2024, me anë të shkresës me Nr.37/6 Prot, datë 16.04.2024 “Kthim përgjigje mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

**1. Lidhur me komentin për Standardi II 6 kriteri 3, nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ vlerëson maksimalisht përpjekjet e institucionit në drejtim të nxitjes dhe motivimit të studentëve në angazhime në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Sygjerimi i GVJ do të sjellë rritje të mëtejshme të këtyre iniciativave.

**2. Lidhur me komentin për Standardi II 6 kriteri 4, nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ kërkon një shpërndarje më të mirë të mbështetjes financiare si dhe transparencë në shpërndarjen e këtyre fondeve, sidomos atyre që jepen nga burime të brendëshme.

Rekomandohet të vihet në dispozicion një grant i veçantë në mbështetje të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe jo mbështetje selective siç përmendet në RVB.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.21, datë 11.05.2018 janë:

1. Institucioni duhet të rekrutojë staf të ri akademik me grada tituj me qëllim uljen e ngarkesës në numër modulesh të stafit akademik aktual si dhe të sigurojë shpërndarjen e lëndëve në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik;
2. Institucioni duhet të shtojë numrin e udhëheqësve dhe mbikqyrësve të praktikave profesionale të studentëve;
3. Institucioni duhet të vendosë kritere rigorozë për pranimin e studentëve me mesatare mbi 7, në nivelin Master i Shkencave;
4. Institucioni të vlerësojë mundësinë e riemërimit të profilit “Ekonomi Evropiane” në “Biznes Evropian”;

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

**Për Rekomandimin e parë**, GVJ pas vizitës në IAL dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dorëzim, konstatoi se sa i takon rekrutimit të personelit të ri akademik, IAL ka bërë përpjekje në këtë aspekt, duke punësuar personel të ri akademik. IAL ka hasur vështirësi në rekrutimin e personelit akademik me grada shkencore, kjo edhe për shkak të pezullimit për një periudhë të gjatë të programeve të ciklit të tretë në vendin tonë. Vlen të theksohet se njëkohësisht ka pasur qarkullim të stafit ekzistues, si rrjedhojë ka ardhur plotësimi edhe me personel të ri. Ndër vite sa i takon evidencave nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të personelit akademik, por vijon në nivele të njëjta. Megjithatë GVJ konstaton se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedurat e nevojshme që i referohen rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik, atij ndihëms akademik dhe administrativ. Ndërkohë, GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Doktor i Shkencave, në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. **Rekomandimi i parë është përmbushur Kryesisht.**

**Për Rekomandimin e dytë**, GVJ konstaton se nuk ka gjetur evidenca të qarta që të tregojnë në mënyrë eksplicite shtimin e numrit të udhëheqësve dhe mbikqyrësve të praktikave profesionale të studentëve. Duke qenë se studentët e programit Master Shkencor përgjithësisht janë të punësuar, dhe zgjedhin vendin e punës për të kryer praktikën profesionale, duke respektuar fushën, ka një lehtësi për pedagogut të angazhuar në udhëheqje. Megjithatë GVJ nuk konstatoi asnjë

problematikë lidhur me ndjekjen e praktikave. **Rekomandimi i dytë është përmbushur Plotësisht.**

**Për Rekomandimin e tretë,** IAL nuk aplikon notë mesatare hyrëse në MSH. Ndërkohë IAL ndërmerri politika të nxitjes të studentëve cilësor dhe me mesatare të lartë përmes bursave të ofruara. **Rekomandimi i tretë është përmbushur Pjesërisht.**

**Për Rekomandimin e katërt,** GVJ konstaton se profili “Ekonomi Evropiane” është mbyllur në vitin 2018 për shkak të interesit të ulët të studentëve. **Rekomandimi i katërt është përmbushur Plotësisht.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti European i Tiranës (UET) është Institucion jo Publik i Arsimit të Lartë (IAL) me financim privat dhe burime të tjera të ligjshme. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, pranë UET ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”. Synimi i UET është të ofrojë mundësi në zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme. UET ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor me qëllim krijimin e specialistëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel rajonal e kombëtar. Veprimtaria mësimore në UET, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” plotëson kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies. Studentet e këtij programi fitojnë njohuri të menaxhimit, ndaj përshtaten më së miri me kërkesat e tregut në këtë fushë. Ata mund të punësohen si:  - menaxherë në ndërmarrjet dhe biznese të ndryshme; - në agjenci të ndryshme shtetërore; - në institucionet e sistemit bankar dhe ato të mikrofinancës; - në institucione politikbërëse në nivel qendror dhe atë lokal;



	<p>- në institucione apo agjenci të tjera publike ose private;</p> <p>- në sektorin privat, banka, institucione të administratës qendrore dhe vendore etj.</p> <p>Plotësimi i këtij kriteri sigurohet gjithashtu edhe nga respektimi i Legjislacionit në fuqi, në mënyrë specifike i ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloreve të tjera të brendshme. Bazuar në Planin Strategjik 2015-2020, gjithë veprimtaria e UET do të zhvillohet në mënyrë që të përfitojë e gjithë shoqëria. Gjithashtu referuar prioriteteve të përcaktuara në Planin Strategjik të UET 2021-2025 institucioni synon të angazhohet në edukimin e çdo studenti duke ofruar edukim cilësor.</p> <p><i>(Aneks 3 Plani Strategjik 2021-2025)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” mbështet zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve dhe përbën një mundësi për të përforcuar lidhjen e studentëve me një sektor apo profesion në për fundim të këtij cikli studimi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Misionin e përcaktuar në Statut të UET ku thuhet se ky Universitet ofron kushte dhe ambijente të përshtatshme, duke aplikuar metoda të avancuara të mësimdhënies dhe program në përputhje me fushat e përcaktuara të studimit. Edhe gjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me Dekanin dhe Shefin e Departamentit është konfirmuar se stafi menaxhues e ka të qartë misionin dhe rolin e programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, në mbështetje të misionit të këtij institucioni. Programi i studimit është poashtu në përputhje me Kartën e Bolonjës në bazë të së cilës janë të orgnuara studimet në UET. Sa i përket cilësisë së mësimin, vihet re aplikimi i metodoave të avancuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Syllabuset janë të përditësura dhe të krahasueshme me programet evropiane të ngjashme.</p> <p><i>(Aneks 2 Statuti i UET; Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023; Aneks 7 Rregullore e Programit te studimit</i></p>

	<i>Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Vizita në institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	<p>Statuti dhe plani strategjik i UET specifikojnë qartë drejtimet prioritare duke vënë theksin në faktin se UET promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit ekonomik dhe social përmes transferimit të teknologjive dhe informacionit, në përgjigje globalizimit tregut të punës dhe diversifikimit të madh të arsimit të lartë në Shqipëri. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, është një program që përmbush vizionin aktual dhe të ardhshëm të UET, pa iu larguar kontekstit ekonomik dhe social të vendit në përputhje dhe në funksion të drejtimeve kryesore akademike të UET.</p> <p><i>(Aneks 2 Statuti i UET; Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023; Aneks 7 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi")</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, është hartuar në kushtet kur nevoja për një administrim të mirë të cdo sektori të ekonomisë vinte gjithmonë në rritje. Në këtë kontekst IAL ka profilizuar këtë program studimesh në tre profile duke patur parasysh dhe kërkesën e tregut të punës. Kjo gjë u thekësua si gjatë takimit me titullarët ashtu dhe gjatë takimit me studentët e këtij programi. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, ka si qëllim përgatitjen e profesionistëve ndërdisiplinorë të integrueshëm dhe të domosdoshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë, shtetërorë dhe privatë.</p> <p><i>(Aneks 2 Statuti i UET; Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023; Aneks 7 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi", Vizita në Institucion)</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>Universiteti Europian i Tiranës, si institucion i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Ai synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. UET funksionon në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe</i>

	<p>aktet e tjera rregullatore të tij. Të gjithë dokumentacionin që UET zotëron e vë në zbatim të funksionit të tij të përditshëm dhe të gjithë të interesuarve.</p> <p>Ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh” ofrohet duke u mbështetur në përvojën shumë vjeçare nga programi i studimit Bachelor “Menaxhim Biznesi”. Programi Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit që nga viti 2009.</p> <p>Janë ndërtuar kushtet optimale për maksimizimin e efektivitetit në mësimdhënie, zhvillimi i praktikave studentore, si dhe marrja e eksperience ndërkombëtare nga studentët dhe stafi akademik në kuadër të projekteve Erasmus+. Në Universitetin European të Tiranës, ndërtimi i programeve të studimit udhëhiqet nga nevojat e biznesit dhe fleksibiliteti për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe hartohen në përputhje me zhvillimin e njohurive në fushën e menaxhimit si dhe në përputhje me të gjitha metodologjitë e reja të mësimdhënies. Ky program ka si qëllim të mundësojë hyrjen në tregun e punës, zotërim të shpejtë të niveleve të mira të njohurive inovative dhe aftësive konkurruese.</p> <p><i>(Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip), Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi, Aneks 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSH Administrim Biznesi)</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik në vend. GVJ gjykon se fusha e përgjithshme e programit të studimit dhe fusha specifike janë në përputhje me orientimin e njësisë kryesore.</p> <p>Në themel të këtij cikli studimesh qëndron nxitja, thellimi kërkimor dhe kombinimi maksimal i zhvillimeve më të fundit në shkencë menaxheriale dhe ekonomike, të cilat japin më shumë mundësi për integrimin e të diplomuarve në tregun e punës. Studimi i trendeve ekonomike dhe atyre teknologjike, me fokusin maksimal ndaj kërkesave gjithnjë e më komplekse të tregut të punës, ndërtimi i modeleve menaxheriale dhe zbatimi konkret i tyre është misioni kryesor i programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit pranë UET.</p> <p><i>(Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSH Administrim Biznesi);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Përmes njohurive teorike dhe praktike, ky program studimesh synon të aftësojë studentët me kapacitet të lartë për integrimin e tyre në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe t'i përgatisë ata si specialistë të aftë në përputhje me përparësitë e zhvillimit të vendit duke ndjekur drejtimin që ofron përmes programeve të studimit bashkëkohore.</p> <p>Studimet në ciklin e dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” synon arsimim të thelluar profesional të studentëve në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, si teorik ashtu dhe praktik. Synohet të sigurohen njohuritë themelore në këto fusha nëpërmjet integritit të mësimimit me praktikën. Misioni i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut është të përgatisë profesionistë të specializuar në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë.</p>

	<i>(Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip), Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	NA
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Pranë Universitetit European të Tiranës, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Nëpërmjet kësaj zyre krijohen mundësi konsultash, orientimesh dhe trajnimesh të ndryshme. Një ndihmë e rëndësishme vjen dhe nga Tutoriati që gjithashtu mbështet studentët në nevojat e tyre për orientim gjatë studimeve universitare por gjithashtu dhe për mundësi punësimi. Ofrohen dhe trajnime për studentët e diplomuar në UET në formën e pjesëmarrjes së studentëve alumni në leksionet e hapura të organizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti. Pjesëmarrja në këto leksione me të ftuar është e ofruar si për studentët aktualë dhe për ata alumni ku studentëve alumni iu ofrohet në këtë formë mundësia që të përditësohen me njohuritë e kërkuara dhe aplikuar në disiplina të ndryshme në ekonomi të sjella sipas argumentit të ekspertizës së të ftuarve. Megjithatë trajnime të mirëfillta për alumni nuk u provua të kishte.</p> <p><i>Sygjerohet që Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, të këtë më shumë angazhin më këtë drejtim.</i></p> <p><i>(Aneks 33. Plani i Trajnimeve)</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Programi i studimeve ka Rregulloren e tij dhe gjithashtu Kurrikula e programit MSH në Administrim Biznesi është e përditësuar dhe bashkëkohore.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, realizon çdo vit vlerësimin e ecurisë së Programeve të Studimit, bazuar në indikatorët themelorë si kurrikula e studimeve, planet mësimore dhe programet mësimore të çdo moduli. Hartimi dhe modifikimi i secilit prej tyre është përgjegjësi e njësive bazë e cila organizon procesin me angazhimin e stafit akademik, apo të njësive të tjera bazë që janë të angazhuara në këtë program studimi. Bazuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, programet hartohen nga titullari i modulit, pedagogu i modulit ose grup pedagogësh, shqyrtohen në grupin e mësimin dhe të kërkimit, në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga Dekani i fakultetit. Hartimi i programeve bazohet në një bashkëpunim midis hallkave të ndryshme në nivel departamenti dhe fakulteti. UET realizon një analizë të përvitshme të procesit mësimor duke u bazuar në treguesit e standardeve shtetërore të matjes së cilësisë në arsimin e lartë, një prej të cilëve është edhe programi i studimit. Raporti final i analizës mësimore është rezultat i analizave mësimore të njësive bazë, realizuar mbi të njëjtën strukturë. Analiza synon të evidentojë arritjet dhe problematikat me qëllim rishikimin e objektivave për përmirësimin e vazhdueshëm të ecurisë së programit të studimit dhe procesit mësimor në tërësi.</p> <p><i>Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi, Aneks 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese MSHAB 22-23</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe homologesh ndërkombëtare dhe vendas në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve. Shumë studentë të gjithë Fakulteteve të UET bëhen çdo vit pjesë e programeve të shkëmbimit me universitete dhe organizata të huaja në kuadër të programeve ERASMUS+. Megjithatë referuar këtij programi studimi duhet të thekësojmë se mareveshjet janë modeste dhe gjithashtu dhe numri i studentëve që kanë realizuar mobilitete në kuadër të programit Erasmus+. Përkatësisht, 7 studente per vitin 17-18, 2 studente per vitin 18-19, 6 studente per vitin 19-20, 1 student per vitin 20-21, 8 studente per vitin 21-22 dhe 8 studente per vitin 22-23, pra ne total 32 studentë për 7 vite.</p> <p><i>Zyra e projekteve dhe vetë Departamenti duhet të angazhohen në shtimin e këtyre mobiliteteve.</i></p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit mandaton kryerjen e praktikave profesionale në insitucione dhe biznese me të cilat institucioni ka marëveshje bashkëpunimi. Në këtë kontekst UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe biznese vendase. Sipas bisedës me titullarët, fakulteti ka ndërmjetësuar rreth 18 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës të cilët shërbejnë si urë lidhëse për kalimin e studentëve nga studimi në tregun e punës.</p> <p><i>(Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi -lista UET, Vizita në Institucion, Dok shtese 2.2. MSH Business Administration outgoing Students)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>UET-ja ka marrëveshje aktive bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë.UET bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh, ku aktualisht janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm si: Lufra, Teuta shpk, Albtelecom, Balfin Group, EHË, Ministri, Agjensi Shtetërore, Institute Kërkimore, si edhe së fundmi ka pasur interes në rritje për të shtrirë bashkëpunimin me qeveritë lokale.</p> <p>Sipas bisedës së realizuar me titullarët ata thekësuan se institucioni bashkëpunon dhe me aktorë e institucione të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë</p>

<p>praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>dakord për të pranuar studentë për zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi -lista UET;</i></p> <p><i>Aneks 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale'</i></p> <p><i>(Aneks Tabela 5;</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut zhvillon mbledhje në mënyrë periodike gjatë të cilave diskutohet rreth projekteve në të cilët janë përfshirë stafi akademik i departamentit dhe rreth mundësive për të thelluar mundësitë e bashkëpunimit, përfshirë realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, kryerjen e praktikave profesionale etj, si dhe për përmirësimin e programeve të studimeve. Gjithashtu, në kuadrin e raporteve të përvitshme të analizës së veprimtarisë së njësive bazë dhe njësive kryesore që diskutohen dhe aprovohen nga stafi akademik, në mbledhjet e departamentit, theksohen çështjet kryesore që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me aktorë/institucione të tjerë në funksion të programeve të studimit.</p> <p><i>Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi -lista UET, Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Marrëdhëniet e bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit janë mjaft të rëndësishme në UET. Në qendër të këtyre marrëveshjeve qëndrojnë kompani private, Institucione publike, IAL vendase dhe të huaja. <u>GVJ sygjeron</u> që të shtohet angazhimi i Zyrës së Projekteve dhe i vetë Departamentit në rritjen e numrit të lëvizjeve të studentëve drejt universiteteve partnere.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------



				X
--	--	--	--	---

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” relizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 kredite ECTS.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet në 4 (katër) semestra akademike, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi” me një nga profilet përkatëse, sipas përcaktimeve në rregulloren e programit dhe kurrikulën akademike përkatëse.</p> <p>GVJ konstaton se lëndët në këtë program studimi janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E). Kategorizimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore mundëson ofrimin e njohurive teorike (kryesisht të shpërndara në vitin e parë akademik) dhe praktike (të programuara për t’u ofruar në vitin e fundit të studimeve). Gjithashtu GVJ konstaton se Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” përmban informacion të plotë dhe të qartë mbi elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, konkretisht:</p> <p>i) Kategoria A: Lëndë bazë- 12 ECTS;</p> <p>ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – 60 ECTS;</p> <p>iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – 18 ECTS;</p> <p>iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – 12 ECTS;</p>

	<p>v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës 18 ECTS;</p> <p><i>Aneks 2. Statuti UET;</i></p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është i fokusuar në përgatitjen e profesionistëve dhe menaxherëve të aftë në fushën e administrim biznesit, me synimin që të diplomuarit të posedojnë aftësitë dhe kompetencat e duhura për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës, në përshtatje të dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në mjedisin e biznesit.</p> <p>Objektivi i këtij program është që t’ju ofrojë studentëve formimin më të mirë teorik dhe praktik, i cili do të mundësojë përparimin e tyre në karrierë e do t’ju japë të diplomuarve një avantazh konkurrense në treg. Ofrimi i programit të studimit me disa profile u mundëson studenteve formimin e shprehive profesionale në një spektër të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Ky program studimi ka të përfshira lëndë të fokusuar në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura me fushën e administrim biznesit.</p> <p><i>Aneks 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit të studimit MSHAB;</i></p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara</p>	<p>Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika profesionale/internship, e cila zhvillohet në vitin e dytë, semestri</p>

<p>ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>i dytë dhe ka 12 kredite ECTS (10% të ECTS total të programit të studimit). Praktika profesionale vlerësohet me notë. Ngarkesa mësimore e saj përfshin një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca), 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj). Sa i takon detyrimeve përmbyllëse, punimit të diplomës, studentët kanë të përcaktuar ngarkesën në 18 kredite ECTS. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome, i cili vlerësohet me notë.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi;</i>  <i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë</p>	<p>NA</p>

<p>mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UET është krijuar me Vendimin Nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike Universiteti European i Tiranës”, VKM Nr. 657, Datë 28.09.2011 – emërtuar “Universiteti European i Tiranës”.</p> <p>Sa më sipër UET nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është i ngjashëm me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><i>Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi; Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në kuadër të vendimit Nr. 310, datë 11.5.2022 PËR SPECIFIKIMET DHE PËRMBAJTJEN E KODIFIKIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, si edhe në përgjigje të Shkresës së MAS nr.prot 295, datë 16.01.2023, GVJ konstaton se UET përmes shkresës me nr.prot 60, datë 31.3.2023, i ka përcjellë MAS listen e programeve të ofruara nga secili department, së bashku me kodin e programit dhe argumentin përkatës.</p> <p><i>Aneks 31.1. VKM Nr.310, datë 11.05.2022_Kodifikimi programeve;</i></p>

	<p><i>Aneks 31.2. Shkresë MAS_Udhëzim_Për afatet e kodifikimit të programeve të studimit;</i></p> <p><i>Aneks 31.3. Shkresë UET_propozimet për kodifikimin e programeve të studimit</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi të tillë, në formën e një program të përbashkë midis IAL-ve vendase apo të huaja, ndaj GVJ konstaton se ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p> <p><i>Aneks RVB_MSH Administrim Biznesi_akreditim periodik; Vizita në IAL</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” përcakton qartë elementët që përbëjnë strukturën e tij, ka të përfshira lëndë të fokusuara në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura më fushën e administrim biznesit, përcakton qartë ngarkesën në kredite, ka përmbajtje të ngjashme me programe të tjera të të njëjtit cikël studimi. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për</p>	<p>Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut (njësia bazë) në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (njësia kryesore). Bazuar Vendimit BA Nr. 82, datë 22.09.2023, UET</p>

organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

është akredituar në nivel Institucional për 4 (katër) vite akademike (22/09/2023 deri në 21/09/2027), duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.

Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente:

1. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut;
2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
3. Qendra për Zhvillimin e Qendrueshëm;

Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (27 pedagogë PAE) dhe 15 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	-
Prof.Asoc	2	1
Dr/PhD	9	9
Dr. proces	7	-
Msc	5	5
<b>Total</b>	<b>27</b>	<b>15</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>42</b>	

Rezulton se çdo njësi bazë e Fakultetit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-	2	-	1	-
Prof. Asoc.	2	2	2	-	2	1	1	-	-	1

Dr./PhD.	4	2	4	2	3	3	4	-	5	5
Dr proc	-	-	-	-	-	1	1	-	2	-
Msc.	1	3	2	3	1	1	1	-	-	2
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>8</b>

Kjo njësi përbëhet nga 2 Grupe Mësimore-Kërkimore:

-Grup-Lënda e Menaxhimit

- Grup-Lënda e Marketingut

PAE në këtë njësi mbulon ngarkesën mësimore sipas përcaktimeve ligjore. Sipas nevojave angazhohen dhe PAK, sipas nje planifikimi që kryet çdo fillim viti akademik.

*Aneks 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse;*

*Aneks Tabela 1\_2;*

*Aneks 24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6,12,7,8);*

*Aneks 2. Statuti UET;*

*Aneks 53.1. VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar;*

*Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore;*  
*Aneks 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik të angazhuar në programin e studimi;*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” ka si lëndë me 12 ECTS praktikën mësimore, e cila realizohet nga studentët, në bazë të akteve të brendshme të miratuara ng institucioni. Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme. Studenti nuk mund të diplomohet (por mund të dorëzojë diplomën) pa kryer detyrimin e praktikës. Zyra e Këshillimit të Karrierës, angazhohet nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e

	<p>praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë.</p> <p><i>(Aneksa 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaston se në bazë të vendimit Nr. 8, date 21.10.2022 të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, është caktuar si koordinator program PhD A. M. e cila është përgjegjëse për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale.</p> <p><i>(Aneks 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale;</i> <i>Aneks 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit;</i> <i>Aneks 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Njësia kryesore ka caktuar koordinatorin e programit se edhe stuktura ndihmës akademike/administrative angazhohen në procesin e realizimit të praktikave mësimore. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, si njësia kryesore, pranë të cilit është dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, në të cilin ofrohet dhe Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim</p>



<p>për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe Vlerësim Projektsh”, është i organizuar në aspektin strukturor akademik, në bazë të statutit dhe rregullores së përgjithshme të institucionit. Kjo njësi kryesore dhe njësia bazë kanë të mirëpërcaktuara në rregulloret përkatëse detyrat dhe funksionet. Njësitë (njësia kryesore dhe bazë) përgjegjëse për këtë program studimi kanë informacionin e nevojshëm akademik dhe administrative, të cilin e sigurojnë përmes folderit të përbashkët elektronik "Dokumentat UET".</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, është bazuar në aktet e brendshme bazë të institucionit si dhe në aktet e brendshme, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi. Kurrikula e programit të studimit është e organizuar në bazë të krediteve ECTS dhe orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit (orët individuale) për cdo lëndë. Lëndët në këtë program studimi janë lëndë që zhvillohen vetëm në një semestër akademik. Programi i studimit përmban informacionin e duhur akademik / mësimor, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSH Adminstrim Biznesi (Aneks_Tabela 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se rregullorja e Programit të studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, ka të përcaktuar qartë dhe në mënyrë eksplicite të gjitha informacionet e nevojshme për studentët duke filluar nga kriteret specifike të pranimit, strukturën e programit tëstudimit, objektivat e programit të studimit sipas të gjitha profileve, kreditet, systemin e vlerësimit, transferimin dhe ekuivalentimin e lëndëve. Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e rregjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit ofron informacionin e plotë mbi lëndët, orët akademike dhe formën e shpërndarjes së tyre në formën e leksioneve dhe seminareve si dhe orët e punës individuale nga ana e studentëve, numrin e krediteve ECTS, vitin/semestrin akademik ku zhvillohet.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSH Administrim Biznesi (Aneks_Tabela 9))</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë për këtë program studimi, diskuton në mbledhjet e kësaj njësie përmirësimin e programeve të lëndëve, në lidhje me literaturën që do të përdoret dhe temave që lidhen me aktualitetin. Çdo vit kërkohet përmirësim i syllabuseve, të cilat duhet të miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore. Dosja arkivohet në dy gjuhë në department. GVJ konstaton se janë realizuar disa përshtatje në këtë program, ku lëndë të caktuara janë bashkuar dhe integruar në një lëndë të vetme, apo lëndë të cilat janë riemërtuar.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 53.1. VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar;</i></p> <p><i>Aneks 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Aneks Tabela 11)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ gjykon se Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” përmban të gjitha informacionet e domosdoshme për studentin. Ky program është në kërkim të përmirësimit çdo vit akademik për t’u përshtatur me të rejat e fundit dhe kërkesat e tregut.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është në përputhje me fushën e studimit që ofron programi. Ky program përmes lëndëve që ofron, literaturës përkatëse mundëson që studentët të kenë mundësi të thellojnë njohuritë e tyre. Aktivitetet dhe veprimtaritët që përfshihen në programin e studimeve ndihmojnë në zhvillimin e aftësive, përmes një kombinimi të mësimit teorik dhe praktik, duke i përgatitur ata për sfidat e studimeve të mëtejshme ose për t’i bërë ata konkurrues në tregun e punës. Përmbajtja e kurrikulës së këtij programi studimi mundëson njohuri bazë dhe të thelluara në fushën e menaxhim biznesit dhe është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij programi, të cilat janë të parashikuara dhe në rregulloren e tij.</p> <p><i>Aneks 3 Plani Strategjik UET 2021-2025;</i></p> <p><i>Aneks 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit MSHAB;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tab.23)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të</p>	<p>Ndërthurja e materieve themelore dhe opsionale siguron një bazë të fortë dhe një spektrum të gjerë të njohurive. Plani mësimor ka të përcaktuar qartë organizimin kohor të programit, duke specifikuar se si lëndët janë të shpërndara gjatë viteve dhe semestrave. Shpërndarja kohore ndihmon në përgatitjen graduale të studentëve për njohuritë dhe aftësitë që do të zhvillojnë, duke e shpërndarë ngarkesën në gjithë ciklin. Organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 4 (katër) semestra me</p>

<p>nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>kohëzgjatje normale 15 javë. Të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar numrin e krediteve, shpërndarjen e orëve mësimore, formën e orëve mësimore (leksione/seminare), objektivat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, format e kontrollit të njohurive, komponentët e vlerësimit dhe shpërndarjen e tyre përgjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit ka një strukturë të mirë që siguron një rrjedhë logjike të lëndëve dhe aktiviteteve që ndihmojnë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre të mësimi. Gama e gjerë e lëndëve ndihmon në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Ky program studimi ofron njohuri bazike dhe të thelluara në fushën e menaxhim binesit. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Raporti i lëndëve teorike me ato praktike është i përshtatshëm për këtë program studimi dhe në përputhje me objektivat e tij. Ky kombinim i teorisë dhe praktikës ofron mundësi për studentët për ti përgatitur ata për sfidat e tregut të punës. Bazuar vizitës në institucion u theksua se ky program është hartuar duke marrë në konsideratë praktika ndërkombëtare dhe literaturën e huaj, duke e orientuar në standarde ndërkombëtare.</p> <p><i>Aneks 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit MSHAB;</i></p> <p><i>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit ofron nje nderthurje midis formimit teorik dhe praktik. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Bazuar në programin e studimit konstatojmë se lëndët karakterizuese kanë peshën më të madhe, 60 ECTS, duke u fokusuar në formimin e studentit në fushën e kërkuar. Struktura e këtij programi studimi mundëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit. Ky mobilitet brenda vendit mund të realizohet</p>

	<p>lehtësisht nga studentët për shkak të afërsisë dhe përshtatshmërisë së këtij programit me atë që ofrojnë universitetet e tjera në vend.</p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi përditëson dhe përmirëson programet e lëndëve në koherencë me zhvillimet bashkohore, duke pasqyruar zhvillimet e fundit në fushën e administrim biznesit. Sipas takimeve në institucion, çdo vit diskutohet përmirësimi i programit për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën e administrim biznesit. Literatura përbëhet nga literatura bazë e detyrueshme dhe literature ndihmëse.</p> <p><i>Aneks 4. Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te studimit MSHAB;</i></p> <p><i>Aneks 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Ky program studimi mundëson për studentët njohuri të thelluara në fushën e administrim biznesit. Përmbajtja e programit është e dizajnuar në mënyrë që të plotësojë synimet dhe objektivat e përcaktuara, duke siguruar që studentët të marrin njohuri dhe aftësi të përshtatshme për fushën e administrim biznesit.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p> <p><i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Programi i studimeve në Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektësh” mundëson për të diplomuarit vijimësinë e studimeve në ciklin e tretë të studimeve si dhe daljen e tyre në tregun e punës në profesionet:</p>

<p>prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Administrator i përgjithshëm në organizata publike, private, jo fitim prurëse;</li> <li>2. Analist i proceseve operacionale;</li> <li>3. Analist tregu;</li> <li>4. Administrator në institucionet e qeverisjes vendore;</li> <li>5. Administrator në sektorin e shërbimeve publike;</li> <li>6. Administrator i përgjithshëm i institucioneve kombëtare ekzekutive;</li> <li>7. Drejtues në sektorin e shërbimeve të administratës publike;</li> <li>8. Drejtues në administratën publike;</li> <li>9. Drejtues ne sektorin e kostove dhe çmimeve;</li> <li>10. Drejtues projektsh;</li> <li>11. Ekonomist ne sektorin e administrates publike;</li> <li>12. Hartues buxheti ne sektorin privat dhe ate public;</li> <li>13. Hartues dhe vleresues i plan bizneseve dhe projekteve;</li> <li>14. Manaxher marketingu;</li> <li>15. Manaxher ne sektorin bankar;</li> <li>16. Manaxher ne sektorin e sigurimeve;</li> <li>17. Manaxher portofoli;</li> <li>18. Manaxher shitjesh;</li> <li>19. Menaxher i burimeve njerezore;</li> <li>20. Menaxher projekti;</li> <li>21. Menaxher investimesh;</li> <li>22. Menaxher marketingu;</li> <li>23. Menaxher reklame dhe promocioni;</li> <li>24. Sekretar i Përgjithshëm në Ministri;</li> <li>25. Specialist per Operacionet (Head of Operations);</li> <li>26. Specialist i sherbimit civil;</li> <li>27. Specialist i treguesve ekonomik (Instat);</li> <li>28. Studiues dhe perpunues i te dhenave ekonomik – statistikore;</li> </ol> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi përditëson dhe përmirëson programet e lëndëve në koherencë me zhvillimet bashkohore, duke pasqyruar zhvillimet e fundit në fushën e administrim biznesit. Sipas takimeve në institucion, çdo vit diskutohet përmirësimi i programit për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën e administrim biznesit. Konsultat zhvillohen me Bordin e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive.</p> <p><i>Aneks 12.1 Bordi i Tregut të Punës;</i> <i>Aneks 17. Studimi për tregun e punës për programin MSH AB)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët janë të pëfshirë në organe vendimmarrëse si Senati Akademik, Keshilli i Etikes, KSBC. Organizohen takime periodikisht me studentët për të diskutuar nga afër mbi programin e studimit. Sa i takon studentëve të diplomuar Alumni, UET në strukturën e Bordit të Tregut të Punës, e ngritur pranë departamentit, në përbërjen e tij ka student alumni. Me këtë bord konsultohet mbi përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Nuk konstatohet ndonje angazhim më i gjerë i studentëve të diplomuar alumni.</i></p> <p><i>Aneks 12.1 Bordi i Tregut të Punës;</i> <i>Aneks 2. Statuti (anglisht);</i> <i>Aneks 3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia bazë është e angazhuar në përmirësimin e programit të studimit, dhe në këtë kuadër organizon konsulta me Bordin e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se IAL-ja nxit përfshirjen e studentëve dhe Bordin e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.6</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi është përshtatur me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen dhe me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Pjesë e veprimtarive mësimore është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.</p> <p><i>Aneks 3. Plani Strategjik UET 2021-2025;</i> <i>Aneks 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025)</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë për këtë program studimi, mundëson për stafin akademik dhe administrativ që angazhohet në këtë program, bashkëpunim në funksion të procesit akademik-shkencor.</p> <p>Sipas takimit në IAL institucioi mbështet arritjet akademike dhe kërkimore shkencore të stafit akademik. Mbështetja duhet të jetë në formë financiare, përmes financimit të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore shkencore, financim të publimit të artikujve apo pjesëmarrjes në konferenca. <u>Rekomandohet të vihet në dispozicion një grant i veçantë në mbështetje të veprimtarisë kërkimore shkencore.</u></p> <p><i>Aneks 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ bazuar takimit në IAL evidentoi se ky institucion përpaket të nxisë studentët që të angazhohen në trajnime dhe projekte të ndryshme. Një ndër aktivitetet e zhvilluara është Konferenca e Ditëve të Studimeve Shqiptare (DSSH) të kërkuesve të rinj, si një aktivitet shkencor ku prezantohen temat më cilësore të studenteve Master, ku temat më të mira kanë mundësinë të publikohen në revistën shkencore UET, "Economicus".</p> <p><i>Megjithatë rekomandohet të zhvillohen më shumë iniciativa dhe të zgjerohet gama e aktiviteteve ku të përfshihen studentët në studime apo aktivitete kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Dy janë kanalet e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore, kryesisht grantet nga donatorë të huaj të përfutur nga aplikimet në programe financimi të huaja në të cilat aplikon Zyra e projekteve dhe Partneriteteve dhe sy dyti nga financimet e brendshme që alokohen <u>në mënyrë selektive për fakultet (sipas RVB)</u>. Sa i takon këtij financimi të brendshëm me burime financiare të institucionit nuk ka evidence të mjaftueshme. Gjatë takimit në IAL me stafin akademik, u bë e ditur se ka pasur një praktikë që stafi kur përfiton një grade shkencore apo titull akademik më të lartë përfiton një grant prej 2500 euro. Nuk kemi evidence për ta konfirmuar përfitimin e këtij granti apo qëndrueshmërinë e tij.</p> <p><u>Rekomandohet të vihet në dispozicion një grant i veçantë në mbështetje të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe jo</u></p>

	<p><i>mbështetje selective siç përmendet në RVB. Sa i takon mbështetjes nga projekte ndërkombëtare, bazuar listës së projekteve konstatohet se projektet lidhur me këtë program studimi nuk janë të mjaftueshme. Nuk ka evidence që të ardhurat të administrohen nga njësia bazë.</i></p> <p><i>Aneks 28.5. Lista e projekteve ku është përfshirë DMM; Aneks 11. Projektet_Lista e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit MSH Administrim Biznesi</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon se programi i studimit ofron orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor por nuk ka mjaftueshëm angazhim të studentëve dhe as financim të kërkimit shkencor për këtë program studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë për këtë program studimi, bashkëpunon me zyrat përkatëse për realizimin e projekteve. Drejtimi i kërkimit shkencor i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, është i përqëndruar në Qendrën për Zhvillimin e Qëndrueshërn. Sipas takimit në IAL të zhvilluar me përfaqësues nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve u konstatua se në rolin e koordinatorit/menaxherit janë personel administrativ nga kjo zyrë. Po ashtu nga lista e projekteve të vëna në dispozicion, rezulton se ato i përkasin gjithë IAL-së dhe jo vetëm departamentit në fjalë. Njëkohësisht vihen re më shumë projekte me fokus në ndërtim kapaciteti sesa kërkimore-shkencore.</p> <p>Sqarim: Projektet për ndërtimin e kapacitetit nuk janë të njëjta me projektet kërkimore shkencore, megjithatë, ato kanë për qëllim të</p>

	<p>përmirësojnë aftësitë, njohuritë dhe kapacitetet në një fushë të caktuar. Këto projekte përqendrohen zakonisht në zhvillimin e aftësive praktike, trajnimeve, krijimit të kapaciteteve institucionale, dhe ndërtimin e marrëdhënieve me partnerët.</p> <p>Në anën tjetër, projektet kërkimore shkencore kanë një qëllim tjetër kryesor, atë të prodhimit të njohurive të reja, zbulimeve, dhe kuptimit më të thellë të një teme apo fenomeni të caktuar. Këto projekte përfshijnë shpesh hulumtim të thelluar, eksperimente, analiza të të dhënave, dhe interpretim të rezultateve për të arritur në konkluzione shkencore. Kërkimi shkencor është pjesë e procesit të zhvillimit të dijes dhe është i rëndësishëm për përparimin e një fushe të caktuar shkencore.</p> <p><i>Rekomandohet angazhim më i madh në role koordinimi i personelit akademik në projekte si edhe më shumë agazhim në pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Njësia bazë Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut angazhdon studentët në pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore, duke organizuar konferenca si Konferenca e Ditëve të Studimeve Shqiptare (DSSH). <i>Rekomandohet të angazhohen studentët në më shumë studime e projekte.</i></p> <p>Njësia angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte duke angazhuar personelin akademik. Megjithatë evidencat nuk janë të mjaftueshme, që të tregojnë se në cilat studime apo projekt aplikime personeli akademik i këtij program studimi është përfshirë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se aktivitetet në këtë kuadër janë DSSH, si dhe boton revisten shkencore "Economicus".</p> <p><i>Rekomandohet më shumë angazhim.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit përmban lëndët e përshtatshme për formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e punës.</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	NA			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Ky program, për shkak të natyrës së tij, nuk aplikon pajisjen e studenteve me marrjen e licencës së profesionit përkatës, por i pajis ata me diplomën përkatëse: Master i Shkencave "Administrim Biznesi" me profile.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se nevojitet më shumë angazhim në përfshirjen e studentëve në studime dhe projekte kërkimore, po ashtu rekomandohet të zhvillohen më shumë veprimtari në këtë kuadër. <u>Rekomandohet</u> angazhim më i madh në role koordinimi i personelit akademik në projekte kërkimore shkencore dhe rritje e numrit të aplikimeve specifiku për fonde në programe me fokus kërkimin shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</b></p>	<p>Në ciklin e II-të studimeve Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, stafi akademik i angazhuar ndjek me rigorozitet përcaktimet në kuadrin ligjor e rregullator mbi format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të njohurive. Bazuar në Rregulloren e departamentit, në këtë cikël studimesh format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione, seminare/orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktike profesionale, tema diplome/provim formimi. Çdo vit akademik, departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përgatit dosjen e plotë të programit të studimit. Në dosje përfshihen planet mësimore, struktura e vitit akademik, planet e ngarkesave mësimore, planet kalendare, plani i performancës akademike, etj.</p> <p>Për çdo modul të kurrikulës së programit mësimor hartohen dhe depozitohen në departament syllabuset përkatës, në mënyrë që të dhënat e tabelave të planeve mësimore të gjejnë pasqyrim të plotë në organizimin e elementëve përbërës të secilit syllabus dhe programet e lëndëve. Syllabuset janë objekt kontrolli i përvitshëm. Ky kontroll zhvillohet nga departamenti me miratimin e fakultetit. Në syllabus pasqyrohen të gjithë elementët e nevojshëm sipas VKM Nr.41. Syllabuset dhe planet kalendare për secilin modul ndodhen në Sekretarinë e Departamentit. Syllabuset dhe planet mësimore përfshijnë të gjitha format e mësimdhënies të miratuara nga UET siç janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, laboratorët, etj. Duhet theksuar që në kurrikulën e studimeve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, i është dhënë hapësirë e gjerë praktikës profesionale si në kredite ashtu edhe në kohë, me qëllim</p>

	<p>aftësimin profesional të studentëve. Praktika profesionale synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve të fituara gjatë kohës së studimeve në Fakultet, njohjen e tyre me aspekte teknike dhe të organizimit të punës si dhe t'u japë njohuri dhe përvojë praktike në ushtrimin e aktivitetit profesional.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 14.4 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSH Adminstrim Biznesi</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies përbën procesin që ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarëvajtjen ashtu dhe në aspektin cilësor. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen dhe përdoren për programet e ciklit të dytë janë të shumëllojshme. Këto forma parashikohen më së miri në planet mësimore dhe programet/syllabuset e moduleve, të cilat gjenden në sitet personale të pedagogëve. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies, këto metoda tentojnë drejt formave të mësimimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student.</p> <p>Leksionet dhe Seminaret janë në bazë të këtij programi studimi. Raporti i tyre është i përcaktuar qartë në sylabusin e çdo moduli dhe respektohet nga pedagogët e lëndës.</p> <p>Gjatë orëve të seminareve si dhe gjatë detyrave të kursit zhvillohen ushtrime apo punë në grupe më të vogla, për të zhvilluar aftësinë e të punuarit në skuadër si dhe të kuptuarit e roleve individuale brenda një grupi. Sipas natyrës së lëndës dhe projektit, madhësia e grupeve të punës varion. Në praktika dhe workshope apo në procese të caktuara pune, grupet janë edhe më të mëdha dhe në disa raste, në fazat përfundimtare, i gjithë grupi shndërrohet në një skuadër pasi rolet dhe natyra e detyrave individuale që caktohen për secilin janë përplotësuesc.</p> <p>Përveç përfitimit akademik, stimulimit të kuriozitetit dhe mësimimit të pavarur, puna në grup nxit zhvillimin e aftësive, për të cilat ka kërkesa të mëdha nga punëdhënësit, sic janë: aftësitë e bashkëpunimit dhe negocimit; shkëmbimi i ndërsjellë i eksperiencës, fitimi i aftësive komunikuese në prezantimet publike gojore, të shkruar. Krahas të tjerave, gjatë formimit dhe ecurisë akademike, studentët e UET aftësohen në teknika</p>

	<p>prezantimi dhe komunikimi me grupin dhe me të tjerët. Pothuajse çdo lëndë ka si komponent përbërës të mësimit dhe vlerësimit detyrat e kursit/projektet, të cilët kanë përqindjen e tyre në vlerësimin përfundimtar. Çdo detyrë ka një ose disa prezantime para studentëve të tjerë të grupit, por prezantimet janë të hapura edhe për studentë të tjerë të universitetit dhe stafin akademik të interesuar. Theksojmë që, prezantimi i detyrave fillon që në vitin e parë akademik dhe vazhdon këtë proces deri në mbrojtjen e diplomës. Cilësia dhe teknikat e prezantimit vlerësohen dhe përbëjnë një komponent në sistemin përfundimtar të vlerësimit. Teknikat ndihmojnë gjithashtu për t'i përafuar dhe përshtatur ata me kërkesat dhe pritshmëritë e punëdhënësve pas përfundimit të studimeve. Leksionet e hapura me lektorë/profesorë apo dhe specialistë të fushës, janë gjithashtu një formë tjetër e elementëve të mësimdhënies. Gjatë këtyre orëve studentët realizojnë diskutime mbi një çështje kërkimore ku ata kanë ekspertizën përkatëse dhe zhvillojnë punë kërkimore me grupe apo individuale në shkrim artikujsh apo konsulenca për bizneset.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës ka mbështetur vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Kjo dëshmohet edhe nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit, të nënshkruara me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore, nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore, organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. Këto marrëveshje janë shfrytëzuar maksimalisht nga stafi akademik i angazhuar. Gjithashtu orët e hapura dhe diskutimet ndërmjet grupeve mësimore dhe kërkimore mundësojnë përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. UET në politikën e vet të Burimeve Njerëzore ka një perspektivë të qartë për kualifikimin e mëtijshëm akademik dhe shkencor të stafit. UET inkurajon, asiston personelin akademik për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore si dhe në ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme, të cilat synojnë kualifikimin e mëtijshëm të tyre. Institucioni ka aplikuar për</p>

	<p>kualifikimin e metejshëm të stafit akademik të tij nëpërmjet marrëveshjeve me Universitete të huaja, ku stafi i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut është angazhuar në mësimdhënie në kuadër të projekteve të bashkëpunimit si Erasmus+.</p> <p><i>Aneks 43 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit;</i></p> <p><i>Aneks 43.1 Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve;</i></p> <p><i>Aneks 33 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në RVB e dorëzuar nga grupi i punës, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut (viti akademi 2022-2023) përbëhet nga 8 staf akademik efektiv, nga të cilët 1 në kategorinë Profesor, 5 në kategorinë Lektor dhe 2 në kategorinë asistent lektor. Gjithashtu ka dhe 8 staf të ftuar.</p> <p>Stafi i këtij departamenti ka eksperiencë të provuar nga CV e tyre në fushën që ata mbulojnë si dhe në mësimdhënie. Megjithatë nga vizita në institucion si dhe nga vrojtimi i dokumentacionit u vu re:</p> <p>Ka një lëvizje të stafit të departamentit në kohë, pra mungon qëndrueshmëria. Departamenti ka staf të angazhuar prej shumë kohësh ndërkohë që një pjesë tjetër e stafit është në lëvizje të vazhdueshme. Ka largime dhe prurje të reja për këto largime. <u>Sygjerojme që IAL të ndërtojë politika të tilla që të mund të sigurohet qëndrueshmëri e stafit në kohë.</u></p> <p>Nga dosjet rastësore të personelit u vu re se përgjatë rekrutimit të stafit, pësha që zënë rezultatet e studimeve të tyre Bachelor, nuk është e konsiderueshme. Nga dokumentacioni i venë në dispozicion për thirrje për staf të ri është vënë si kriter rekrutues nota mesatare 9 e lart. Ndërkohë që nga dokumentacioni i gjetur në dosjet e personelit nuk rezulton që ky kriter përmbushet, dhe nota mesatare rezulton nën 8. <u>Sygjerojme që duhet të mbahet parasysh në rekrutime të mëtejshme nota mesatare mbi 8-8.5 të sistemit bachelor.</u></p> <p><i>Aneks 19 Syllabuset e Lëndëve të ofruara në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 11 Rregullore për Burimet Njerëzore;</i></p>



	<p><i>Aneks 20 CV e stafit akademik të programit të studimit;</i></p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Siç e përmendëm në kriterin 2, organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies përbën procesin që ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarëvajtjen ashtu dhe në aspektin cilësor. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen dhe përdoren për programin e studimit Master shkencor janë të shumëllojshme. Kontrollat e realizuara nga departamenti dhe dekanati (leksione të hapura) lidhur me disiplinën në procesin mësimor konstatojnë si konkluzion të përgjithshëm, zhvillimin me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve të këtij programi studimesh. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies, këto metoda tentojnë drejt formave të mësimin me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve. Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të drejtpërdrejta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve dhe sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit.</p> <p><i>(Aneks 5 Rregullore e UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Universiteti European i Tiranës merr pjesë dhe ka realizuar shumë projekte bashkëpunimi Erasmus, ku përvec njohjes së programeve në këto projekte sigurohet edhe mobiliteti i stafit akademik. Mobilitetet krijojnë mundësi të reja për bashkëpunime midis stafit të UET dhe universiteteve europiane me profil të ngjashëm. Në kuadër të këtyre projekteve, profesorë të universiteteve të huaja mbajnë leksione të hapura duke sjellë jo vetëm ide të reja kërkimi, por gjithashtu dhe një vizion të ri për realizimin e orëve mësimore, për ti bërë ato sa më tërheqëse dhe produktive për përthithjen e njohurive dhe koncepteve që jepen në leksion dhe auditor.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të projekteve të bashkëpunimit edhe studentët realizojnë një pjesë të kohës nga kohëzgjatja totale e</p>

dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>programit të studimit si p.sh 3-6 muaj duke ndjekur disa module në universitete të huaja. Këto marrëveshje rrisin mundësinë e njohjes po dhe të trajnimit me metodat dhe materialet didaktike që kolegët e universiteteve të huaja përdorin në zhvillimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 2 Statuti i UET;</i></p> <p><i>Aneks 30.4 Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC;</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Universiteti European i Tiranës punon drejt garantimit të procesit të të nxënit dhe aftësimit profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. Lidhur me stafin akademik efektiv UET duhet të punojë më shumë drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë. Gjithashtu sygjerohet të vendosin kritere më të forta rekrutimi për stafin efektiv. Ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve të UET, në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit si dhe në rregulloren e programit të studimit Master Shkencor. Ato janë publike dhe të vendosura në stendat e departamentit. Gjithashtu ato janë të përcaktuara në programet e çdo moduli. Të gjithë këta elementë i bëhen të ditura studentëve dhe janë të publikuara në ëbsite individuale të secilit prej pedagogëve të lëndëve në syllabuset e përditësuara të lëndëve. Nota përfundimtare e studentëve vjen nga disa element, provimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminare apo detyra praktike, provimi përfundimtar.

	<p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Struktura e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara gjatë zhvillimit të modulit bëhet në një ndarje prej vlerësimit i vazhduar dhe provimit përfundimtar. Në vlerësimin e vazhduar përfshihen forma të ndryshme testimi si provime të pjesshme, detyra kursi/projekte që mund të jenë individuale ose në grup, si dhe aktivizimi dhe ndërveprimi aktiv gjatë zhvillimit të seminareve. Mënyra e vlerësimit të njohurive me përqindjet e elementëve përbërës po edhe e natyrës së testimit të njohurive ju bëhen me dije studentëve që në fillim të lëndës. Forma e vlerësimit reflektohet edhe në syllabusin përkatës të lëndës po dhe në planin kalendarik, të cilat gjenden edhe të publikuara në ëbsite e pedagogut. Informimi mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësimit profesional i ndihmon studentët të kuptojnë natyrën e lëndës si dhe të krijojnë idenë mbi përmbajtjen e saj. Bazuar në RVB dhe vizitën në IAL, studentët informohen në platformat LMS dhe TEAMS, apo me anë të postës elektronike në lidhje me format e vlerësimit dhe detyrimet që duhet të përmbushin lidhur me to. Shkalla e përvetësimit të dijeve, me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me gërma nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese.</p> <p><i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS;</i></p> <p><i>Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format e testimit të njohurive do të realizohen në formën e provimeve të pjesshme dhe provimit final, ku do të testohen njohuritë teorike dhe praktike të lëndës. Provimet nuk janë e vetmja formë e testimit të njohurive pasi edhe mbrojtja e detyrës së kursit do t'i japë mundësi studentit që të diskutojë mbi përmbajtjen e detyrës si dhe ta mbrojë detyrën/projektin duke u ushtruar apo punuar edhe në grupe pune. Realizimi i detyrave të kursit apo projekteve i jep mundësinë studentëve që ata të krijojnë edhe një portofol të punimeve të tyre, kryesisht</p>

	kjo për modulet që kanë si bazë programimin dhe këto punime ata mund t'i prezantojnë në intervista të ardhshme të punës. <i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Studentët informohen paraprakisht me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në përputhje me rregulloet e IAL. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentëve në seminare me përqindje sipas syllabusit të hartuar nga pedagogu që zhvillon lëndën nxit dhe promovon ndërveprimin Pedagog-Student në diskutimin e pyetjeve dhe përgjigjeve gjatë zhvillimit të tyre. Pjesëmarrja interaktive me shkruarjen e kodeve dhe ekzekutimin e tyre i ndihmon shumë studentët në përvetësimin e plotë dhe testimin praktik të koncepteve të marra në leksione. Vlerësimi i pjesëmarrjes aktive nxit dhe promovon iniciativën e përfshirjes së studentit në zhvillimin e mësimin në një formë më të pëlqyeshme. <i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i> <i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	Për vlerësimin dhe testimin është përdorur korigjimi elektronik i testeve me sistemin Clean Score që mundësohet nëpërmjet skanimit të përgjigjeve dhe krahasimin me çelësin e dhënë nga pedagogu. Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë, përkatësisht në semestrin e dytë të vitit kalendarik 2019-2020

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>dhe gjatë semestrit të parë të vitit kalendarik 2020-2021 u përdor edhe testimi i njohurive me platformën LMS dhe TEAMS.</p> <p><i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS;</i></p> <p><i>Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p><b>Kriteri 3. Vlerësimi</b> përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i studentit do të jetë shuma totale e pikëve me përqindjet përkatëse të përcaktuara në syllabus e secilit modul që zhvillohet. Në varësi të tipologjisë së lëndës varion dhe ndarja e komponentëve të vlerësimit. Për lëndët e tipologjisë I, aplikohet vlerësimi si vijon, detyra praktike nr.1-30%; detyra praktike nr.2-30%; provimi final-40%.</p> <p>Për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar është i domosdoshmëri vlerësimi me komision.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p>
<p><b>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</b> shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë procesit të vlerësimit të të gjithë elementëve të një moduli si; testi i ndërmjetëm, detyra e kursit, provimi final etj, stafi bën komente në fletore në rastin e provimeve me shkrim ose komente direkte në rastin e provimeve me gojë apo detyrave të kursit, të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij procesi. Për këtë qëllim studentët kanë një periudhë ankimi pasi janë njohur në system me pikët e tyre në provimin përfundimtar. Në kontakte me pedagogët, studentët njihen me vërejtjet e pedagogëve gjatë korrigjimit si edhe me pikat që do të mundësonin një zgjidhje të saktë.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Vizita ne IAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik</b> shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në kuadër të sigurimit të procesit të provimit komisionet e provimit përbëhen nga të paktën 2 pjesëtarë të stafit akademik. Gjithashtu studentit nuk i lejohet të hyjë në sallë pa mjet identifikimi si dhe nuk i lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Një rëndësi të veçantë si nga stafi akademik, por dhe përgjegjësi i departamentit i është dhënë</p>

	<p>hartimit të tezave të reja në çdo sezon provimi si dhe në disa variante. Përsa i përket temave të diplomave, udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 16. A.II. Kodi i Etikës;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë procesit të kontrollit, stafi përcakton pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm në ndarjen e pikëve të tezës. Tezat hartohen në mënyrë që të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të modulit dhe kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.</p> <p>Gjithashtu shumë prej studentëve në realizimin e praktikës profesionale kanë treguar profesionalizëm, seriozitet si dhe përgatitje mjaft të mirë nga realizimi i moduleve dhe janë punësuar si programues pranë firmave programuese pas përfundimit të saj.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve dhe njohjes së tyre nga studentët, këta të fundit kanë të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tyre ose të kundërshtojë rezultatin e marrë. Studentët informohen për orarin e pritjes me pedagogun përkatës. Pedagogu/Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore e UET, Vizita ne IAL;</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Nëse student nuk arrin të plotësojë ankesën e tij nga ballafaqimi me komisionin e provimit, ai mund të paraqesë ankesë te Përgjegjësi i Departamentit apo</p>

jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Dekani. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në këto raste ngrihen komisione të posacme pa praninë e pedagogut të lëndës për rivlerësimin e studentit.  <i>Vizita ne IAL;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent të studenteve. Ky vlerësim bazohet në meritën e çdo student. Studenteve u jepet e drejta e ankimit. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Sipas programit të rishikuar në 2022-2023, kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive të tyre shkencore dhe profesionale. Kjo kurrikul ka gjithsej 9 module të përbashkëta në trug të saj për të 3 profilet. Më pas për secilin profil student duhet të zhvillojnë 3 module të tjera të diferencuara midis profileve. Në përfundim zhvillohet praktika profesionale dhe mbrojtja e temës së Masterit. Studenti në këtë program studimi thellon njohuritë në fushën e ekonomisë dhe të menaxhimit, të marketingur, administrimit public dhe projekteve. Programi i studimit është hartuar duke u bazuar në nevojat e tregut për profesionistë në programim me nivel të mirë ekspertize, fituar kjo nga realizimi i moduleve që kanë në qendër të vëmendjes njohjen dhe thellimin e njohurive në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë.

	<i>Aneks 4 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit, Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi");</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Programi Master i Shkencave në Administrim Biznesi, me profile "Menaxhim Marketingu", "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektësh", ka si synim zhvillimin e aftësive dhe njohurive në fushën e ekonomisë dhe të menaxhimit, të marketingut, administrimit public dhe projekteve. Modulet që zhvillohen në këtë program studimi ndjekin trendin e kërkesave për vende pune në realitetin shqiptar në sektorin privat dhe atë publik.</p> <p><i>Aneks 4 Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit, Aneks14 Kurrikula e programit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi");</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	<p>Në përfundim të modulit stafi akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në programin e modulit. Njësia kryesore dhe njësia bazë organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Ky proces fokusohet kryesisht në rishikimin e programit mësimor duke u nisur nga feedback-u i studentëve, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e përfitimit të kompetencave nga ana e studentëve</p> <p><i>Aneks 19 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i></p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi", Vizita ne IAL);</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të	<p>Stafi i angazhuar në programin e studimit ka kualifikimin e duhur për realizimin e leksioneve dhe seminareve. Mësimdhënia synon të gërshetojë njohuritë teorike me aftësitë praktike, përmes ushtrimeve dhe detyrave ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Gjithashtu në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus, studentëve të këtij programi studimi i krijohet mundësia e realizimit të një periudhe 6 mujore të studimeve në universitete të huaja, në kuadër të marrëveshjeve të ndryshme që IAL ka.</p> <p>UET është pjesë e një grupi projektësh Erasmus+ që kanë si qëllim që të përmirësojnë dhe të përafrojnë praktikat e</p>



<p>përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>mësimdhënies së pedagogëve të UET me IAL partnere në Ballkan dhe Evropë.</p> <p><i>Aneks 43.1. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve;</i></p> <p><i>Aneks 34. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit UET;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Realizimi i orëve të hapura është një mënyrë e mirë për dhënien e disa informacioneve mbi zhvillimet më të reja të punës kërkimore të publikuara në revista apo konferenca kombëtare ose ndërkombëtare. Orët e hapura janë zhvilluar me profesorë të ftuar nga bashkëpunimet e shkëmbimit të stafit, duke sjellë diversitetet dhe duke lejuar edhe bashkëpunimin e stafit akademik me kolegët e tyre në universitetet Europiane për realizimin e projekteve apo punëve kërkimore në grupe pune të përbashkëta. Universiteti ka revistën e tij shkencore, në të cilin pedagogët mund të publikojnë aty përmbledhje të punimeve kërkimore më të fundit që ata kanë realizuar. Kjo jep mundësinë e përditësimit me më të rejat në fushat e ndryshme të ekspertizës së pedagogëve të universitetit.</p> <p><i>Aneks 55.2 Kalendar i aktiviteteve te departamentit;</i></p> <p><i>Aneks 34 Marrëveshja e Bashkëpunimit - Lista UET;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Realizimi i punimeve që zhvillohen në përfundim të studimeve për studentët të cilët plotësojnë kriteret për zhvillimin e një teme diplome kanë një nivel shumë të mirë realizimi duke sjellë një studim të detajuar mbi çështjet qofshin ato të natyrës ekonomike, statistikore apo dhe në realizimin e aplikacioneve si për tregtinë online, sistemet e mësimdhënies apo dhe social media. Këto punime janë prezantuar gjithashtu në konferenca ndërkombëtare. Punimet e realizuara sjellin gjithmonë risi në çështjet që ato zhvillojnë apo mbulojnë. Realizimi i konferencave studentore do të krijojë më shumë hapësira për diskutimin e punimeve të ndryshme si dhe do t'ju mundësojë studentëve paraqitje të punimit të tyre në një prezantim të përmbledhur duke shprehur risitë dhe idetë e reja që ata sjellin. Bashkëpunimi i studentëve me pedagogët sidomos në kërkimin për temën e diplomës është i mirë. Studentët janë përfshirë në</p>

	konferencën shkencore ndërkombëtare që zhvillon UET, Ditët e Studimeve Shqiptare, duke u mbështetur dhe financiarisht. <i>Aneks 3.2. Strategjia Kombëtare e Arsimit-2021-2026;</i> <i>Aneks 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2018-2023)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky program studimi tenton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale e shkencore. Staf i angazhuar në programin e studimit ka kualifikimin e duhur për realizimin e leksioneve dhe seminareve. Mësimdhënia synon të gërshetojë njohuritë teorike me aftësitë praktike. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni i jep mundësinë studentëve për realizimin dhe përmbylljen e provimeve me sezone plotësuese të vjeshtës, përveç sezoneve të rregullta në fund të semestrave kur kryhen modulet. Të gjithë këto sezone dhe periudhat kur ato zhvillohen janë të deklaruara edhe të Rregullorja e Programit të studimit. Secili modul përmbillet me zhvillimin e provimit në fundin e tij. Kjo zgjidhje ka ardhur si një kërkesë gjithmonë në rritje e studentëve, të cilët zgjedhin të vazhdojnë këto programe studimi pranë UET dhe Fakultetit të Ekonomisë, por që në të njëjtën kohë punojnë me kohë të plotë në firma të ndryshme. Finalizimi i ciklit të studimeve bëhet me një temë diplome që punohet nga vetë student nën mbikëqyrjen e pedagogut udhëheqës. <i>Aneks 5 Rregullore UET;</i> <i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli	Njoftimet mbi detyrimet, përveçse shpallen në faqen e universitetit ato dërgohen edhe me email nga sekretaria e

<p>akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>departamentit, pasi studentët pajisjen me një email të IAL kur ata fillojnë studimet pranë UET-së. Gjithashtu detyrimet e mbrojtjes së praktikës profesionale dhe më pas të punimit të temës së diplomës vendosen edhe në standat dhe janë të aksesueshme nga të gjithë. Personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari të caktuar dhe shpallur paraprakisht, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET;</i></p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët e Masterit Shkencor në Administrim Biznesi me profile, kryejnë detyrimet përmbyllëse vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studenti punon temën e zgjedhur nga vetë ai nën mbikëqyrjen e një pedagogu udhëheqës dhe bën mbrojtjen e saj përpara komisionit të mbrojtjes së diplomave.</p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Temat e diplomave në përmbylljen e ciklit të studimit Masterit Shkencor në Administrim Biznesi me profile, fokusohen në studime të fushave të ekonomisë në përputhshmëri me kurrikulën që studentët zhvillojnë gjatë 2 viteve të studimeve. Studenti zgjedh një pedagog për udhëheqjen e diplomës nga Fakulteti i Ekonomisë, në varësi të fushës së ekspertizës që pedagogu ka dhe që ai ofron në realizimin e temës së diplomës. Pedagogu udhëheqës orienton dhe ndihmon studentin në formulimin e temës, përcaktimin e çështjeve që do të trajtohen si dhe në dhënien e sugjerimeve për metodologjinë e trajtimit të temës. Komunikimi midis pedagogut dhe studentit është i vazhdueshëm, deri në përmbylljen me sukses të temës. Tema e diplomës duhet paraqitur bazuar në udhëzimet përkatëse.</p> <p>Pas diskutimit të disa drafteve dhe përmirësimit të punimit, pedagogu miraton punimin e plotë duke firmosur temën e diplomës, në këtë mënyrë duke konfirmuar plotësimin e</p>

	<p>standardeve të temës për t'u paraqitur para komisionit të mbrojtjes.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET;</i></p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i></p> <p><i>Aneks 10 Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nëse gjatë zhvillimit të temës së diplomës studentit mund ti nevojitet përdorimi i ndonjë softëare të vecantë për përpunimin e të dhënave. Atij i jepet mundësia të punojë edhe në laboratorët e fakultetit jashtë orarit të zhvillimit të orëve praktike, kjo e kontrolluar nga personeli përgjegjës për këto labore. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje si aspekte metodologjike të temës, përpunimi i të dhënave, punën në terren dhe mbledhja e të dhënave, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET, Vizita ne IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Pasi studentit përfundon mbrojtjen e temës së diplomës, procesi finalizohet me marrjen e notës dhe krediteve. Për vlerësimin final të studentit jep vlerësimin udhëheqësi i punimit të diplomës, oponenti dhe çdo anëtar pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Diplomave. Në fund diskutohet dhe vendoset nota finale, që llogaritet nga mesatarja e vlerësimeve të vendosura. Rezultati për secilin student diskutohet nga komisioni dhe studentët marrin përgjigje brenda ditës së zhvillimit të provimit. Nëse ka kontestime nga studentit, rezultati do të diskutohet edhe njëherë nga komisioni, i cili do të marrë vendimin për ndryshim ose jo të rezultatit të provimit.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET;</i></p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve,</p>	<p>Studentit pas përfundimit të studimeve, brenda 6 muajsh pajiset me diplomë dhe gjithashtu përveç listës së notave me modulet që ka zhvilluar, ai merr edhe suplementin e diplomës ku përshkruhen modulet me përmbajtjen e tyre, të vulosura.</p> <p>Modelet e diplomës për çdo program studimi të UET, miratohen nga Senati Akademik. Elementët përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga</p>

<p>studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>ministra përgjegjëse për arsimin. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të cikleve të studimit shoqërohen me suplementin e diplomës.</p> <p><i>Aneks 9 Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore;</i></p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET;</i></p> <p><i>Aneks 7 Rregullorja e Programit të studimit Master Shkencor në "Adminstrim Biznesi";</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Rezultatet e provimit të formimit ose mbrojtjes së diplomës po ashtu edhe ai i praktikës profesionale dhe të gjithë provimet e moduleve që studentët zhvillojnë gjatë kryerjes së këtij cikli studimi ruhen në hard copy të firmosura nga komisioni, përgjegjësi i departamentit, nga sekretaria e programit të studimit. Këto procesverbale të firmosura ngarkohen dhe në rast mospërputhje me procesverbalin e publikuar nga pedagogu i lëndës ai gjeneron problem. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna sipas kërkesave të të tretëve apo nevojave të vet institucionit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti European i Tiranës ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Shkencor. Dokumentacioni i nevojshëm është në përputhje me urdherat në fuqi dhe rregulloret e IAL. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.6**

Në rastin e programit të studimit në "Master Shkencor" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>UET dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit kanë vënë në dispozicion të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve/laboratorëve, ambiente komode të pajisura me pajisjet e nevojshme si kompjutera me programet e nevojshme për zhvillimin e seminareve të lëndëve/moduleve përkatëse, projektorë, dërrasa elektronike. Këta laboratorë kanë lidhje në internet dhe studentëve i demonstron edhe instalimi i softëareve apo librarive të nevojshme në realizimin e moduleve të ndryshme. Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem efi. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Departamenti Menaxhimit dhe Marketingut, përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse.</p> <p><i>Aneks 42.1 Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit;</i></p> <p><i>Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi – lista UET;</i></p> <p><i>Aneks 32 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Studentët zhvillojnë praktikat profesionale pranë institucioneve publike dhe sektorin privat bazuar në marrëveshjet që IAL ka nënshkruar paraprakisht. Praktika profesionale i krijojnë mundësinë studentëve të njihen me kërkesat e vendeve të punës që profili i tyre ofron. Në të njëjtën kohë ata mund të vënë në zbatim njohuritë e tyre të fituara gjatë ciklit të studimeve duke punuar në projekte reale.</p> <p><i>Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi – lista UET;</i></p> <p><i>Aneks 32 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe</p>	<p>Në provimin e praktikës studentët dorëzojnë krahas dokumentit (kontratës) standard të firmosur nga Dekani, në të cilën vendoset emri i studentit dhe institucionit apo kompanisë ku ata kanë ndjekur praktikën profesionale edhe një dokument i dytë që përfshin vlerësimin e specialistëve pranë të cilëve studenti ka</p>

dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	ndjekur dhe ka zhvilluar praktikën. Ky dokument arkivohet në sekretarinë e departamentit.  Pas përfundimit të praktikës, e cila përfshin një periudhë prej 14 javësh, studenti prezanton para komisionit punën dhe rolin që ai ka pasur në institucionin apo kompaninë ku ai e ka zhvilluar atë dhe pas mbrojtjes së praktikës, vlerësohet me notën përkatëse si përmbushje e detyrimeve të praktikës profesionale.  <i>Aneks 14 Kurrikula e programit Master Profesional Menaxhim Biznesi (shqip);</i>  <i>Aneks 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit në “Master i Shkencave” ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës profesionale dhe teorise. IAL ka nje sere mareveshjesh me institucione publike dhe private per realizimin e praktikës profesionale. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës</b>	Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga staf akademik efektiv dhe me kontratë. Nga

akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2018- 2022 është si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018- 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 4 PAK (75 % /25 %);
2. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 4 PAK (75 % /25 %);
3. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 4 PAK (71% / 29 %);
4. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 3 PAK (82 % / 18 %);
5. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 15 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 4 PAK (74% / 26 %):

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	-	3	1	3	-	2	-	1	-
Prof. Asoc.	5	1	3	-	2	2	2	1	1	-
Dr./PhD	4	2	6	2	5	2	8	1	8	2
Msc.	-	1	-	1	-	-	1	1	1	2
<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>11</b>	<b>4</b>

PAE në këtë njësi mbulon ngarkesën mësimore sipas përcaktimeve ligjore. Sipas nevojave angazhohen dhe PAK, sipas nje planifikimi që kryet çdo fillim viti akademik.

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit në Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile "Menaxhim Marketingu", "Administrim



	<p>Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, janë angazhuar edhe PAK me Msc, në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.</p> <p><i>GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1_2);</i></p> <p><i>Aneks 24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6,12,7,8);</i></p> <p><i>Aneks 2. Statuti UET;</i></p> <p><i>Aneks 53.1. VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar;</i></p> <p><i>Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore;</i></p> <p><i>Aneks 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4))</i></p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik në kuadrin e përgjegjësive institucionale, përveç veprimtarive të mësimdhënies, kryen edhe kërkim shkencor, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët si dhe shërbime administrative. Shpërndarja e ngarkesës mësimore merr në konsideratë edhe përgjegjësitë administrative të stafit akademik në funksion të menaxhimit të programit të studimit. Nga verifikimi i të dhënave statistikore u konstatua se mbulimi i ngarkesës mësimore sipas viteve akademike në këtë program studimi është si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="611 1666 1385 1960"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Ngarkesa mësimore (orë)</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>1470</td> <td>1170</td> <td>300</td> <td>79%-21%</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>1755</td> <td>1395</td> <td>360</td> <td>79%-21%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>1515</td> <td>1215</td> <td>300</td> <td>80%-20%</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Ngarkesa mësimore (orë)	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2018-2019	1470	1170	300	79%-21%	2019-2020	1755	1395	360	79%-21%	2020-2021	1515	1215	300	80%-20%
Viti	Ngarkesa mësimore (orë)	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2018-2019	1470	1170	300	79%-21%																	
2019-2020	1755	1395	360	79%-21%																	
2020-2021	1515	1215	300	80%-20%																	

	<b>2021-2022</b>	1695	1395	300	82%-18%
	<b>2022-2023</b>	1335	1065	270	79%-21%

Sa më sipër GVJ konstaton se ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

*(Aneks 24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6,12,7,8)*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

IAL parashikon rregullime të detajuara në lidhje me procedurat e përzgjedhjes dhe rekrutimit të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Procedurat e punësimit finalizohen me lidhjen e kontratës së punës për të gjitha kategoritë e personelit akademik. Rregullimet në lidhje me kontratën e punës, kushtet dhe kohëzgjatjen, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik janë të detajuara në Statutin e Universitetit si dhe referojnë në Kodin e Punës, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Statuti i Universitetit përcakton në detaje kushtet mbi kohëzgjatjen e kontratës së punës në varësi të kategorisë së personelit akademik, atij me kontratë dhe atij efektiv. Parashikime të detajuara mbi kontratat e punës, kriteret dhe procedurat e punësimit gjenden edhe në akte rregullore të posaçme që i referohen marrëdhënieve të punës.

*(Aneks 2. Statuti UET\_struktura organizative aktuale; Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore)*

**Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,

IAL pranon aplikime për personel akademik gjatë të gjithë vitit. Për t’u përfshirë në procesin e përzgjedhjes, kandidati duhet të dorëzojë një CV dhe një letër interesi ku shprehen kualifikimet dhe fusha e studimit ku kandidati mund të japë kontribut në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor.

Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nevojat për personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e njësisë bazë, si dhe ngarkesat mësimore

<p>strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>të miratuara. Vlerësimi bëhet në bazë të kriterëve të përgjithshme dhe specifike, të cilat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit;</li> <li>-Të ketë së paku gradë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik,</li> <li>- Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;</li> <li>- Rezultatet personale të kandidatit në studime;</li> <li>- Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;</li> <li>- Motivët kryesorë për t'u bërë pedagog në UET;</li> <li>- Aftësitë komunikuese dhe etika;</li> <li>- Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;</li> <li>-Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;</li> </ul> <p>Sa i takon programit të studimit në Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile "Menaxhim Marketingu", "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", në mënyrë rigoroze personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës". Nga vizita në IAL, GVJ-së ju parashtruan dhe vështirësitë që has tregu i punës dhe sfdat e institucionit në këtë drejtim.</p> <p><i>(Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore; Aneks 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore,</p>	<p>Për realizimin e këtij programi studimi institucioni ka anagazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm i cili ndihmon dhe mbështet realizimin e veprimtarisë mësimore. Aktet normative parashikojnë gjithashtu rregullime në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit të kësaj kategorie me qëllim rekrutimin e personelit të kualifikuar dhe garantimin e qëndrueshmërisë në detyrë. Statuti ka parshikime të detajuara në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe elementët që lidhen me</p>

<p>sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>kontratën e punës. Punësimi i personelit ndihmës akademik gjithashtu realizohet nëpërmjet procedurave të konkurimit ku përfshihen një sërë strukturash.</p> <p><i>(Aneks 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore; Aneks 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni administron të dhënat që i referohen burimeve njerëzore të angazhuar në programin e studimit. Në të dhënat e administruara specifikohet mënyra e angazhimit të personave përgjegjës për çdo vit akademik apo semestër. Këto të dhëna menaxhohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Personeli raporton për arritjet profesionale në bazë vjetore. Zyra e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse administrative, ruan dhe përditëson si të dhënat e stafit akademik, ashtu edhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Administrimi i të dhënave të personelit realizohet si në formatin fizik, nëpërmjet dosjeve të personelit, ashtu edhe në formatin elektronik.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka krijuar lidhje me përfaqësues të biznesit dhe kompanive për ofrimin e mundësive të praktikës profesionale për studentët. Në këtë kuadër janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në të cilat, studentëve u mundësohet logjistika dhe mbështetja e nevojshme në zhvillimin e praktikave. Njësia bazë ka burimet e nevojshme njerëzore për të mundësuar mbështetjen dhe asistencën ndaj studentëve në veprimtari të funksion të programit të studimit, për të ofruar instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në fushën e tyre të studimit. Institucioni është përfshirë në udhëzimin e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe aktivitete të tjera specifike të përcaktuara nga natyra e programit të studimit.</p> <p>Zhvillimi i praktikës profesionale, është një ndër lëndët e detyrueshem në kurrikulën e këtij program studimi (12 ECTS). Praktika Profesionale për programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca),</p>

	<p>240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj). Praktikrat profesionale zhvillohen nën drejtimin e pegagogut mbikqyrës të caktuar nga departamenti, i cili asiston studentët. Aktet e posaçme regullatore kanë përcaktura në detaje kompetencat dhe rolin e mbikqyrësit si dhe aspektet e bashkëveprimit me studentët dhe përfaqësuesit e institucionit ku zhvillohet praktika.</p> <p>Në rast se studenti gjatë kohës që është i regjistruar në programin e studimit dhe njëkohësisht është i punësuar, vendi i punës i njihet si vendi i praktikës me kushtin që puna që kryen të jetë në të njëjën fushë me programin e tij të studimit.</p> <p><i>(Aneks 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikrat profesionale (Aneks Tabela 5); Aneks 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale)</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës. Kjo është bërë e ditur gjatë viziatve në institucion.</p> <p><i>Nuk konstatohen evidenca nëse personeli mbikqyrës në ambientin pritës pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktiken profesionale.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p> <p><i>Njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, përbëhet nga stafi akademik me kohë të plotë (PAE) dhe stafi akademik</i></p>

	<p>me kohë të pjesshme (PAK), të kualifikuar dhe me përvojë profesionale, sipas standardeve të përcaktuara ligjore.</p> <p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedurat e nevojshme që i referohen rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik, atij ndihëms akademik dhe administrativ.</p> <p><u>Ndërkohë GVJ rekomandon</u> të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ gjykon se program i studimit bazuar numrit të studentëve realizohet në një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafin akademik. Raporti pedagog student = 1 pedagog me 30 studentë Institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme e të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies si salla leksioni dhe seminaresh, sallë konferencash, aktivitetesh, laboratorë me pajisje kompjuterike, biblioteka, etj.</p> <p>Pas vizitës në institucion dhe bazuar RVB, GVJ konstaton se aktualisht në selinë e re të UET janë në përdorim: 13 salla për seminare - 353 vende, 15 salla leksioni - 1138 vende, 7 laboratorë informatike - 190 vende, 1 sallë interneti - 70 vende.</p> <p>Po ti referohemi infrastrukturës në selinë e mëparshme, në përdorim ishin: 14 salla seminari secila me 35 vende/karrige, 9 salla leksioni dhe seminari 70 vendesh, 3 salla laboratorë</p>

	<p>informatike me kapacitet 35 vende, 1 salle interneti me 80 kompjutera, 1 sallë biblioteke me 150 vende leximi.</p> <p><i>(Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Aneks 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore që i dedikohen programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh” përdorin metodologji dhe teknologji bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Këto mjedise janë të paisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike, mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni. Të gjitha salat kanë system kondicionimi. Të gjitha mjediset mbulohen me WI-FI që mundëson akses ndaj internetit në platformat LMS dhe Microsoft TEAMS.</p> <p><i>(Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Aneks 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset që institucioni ofron përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p> <p><i>(Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Aneks 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përmbush këtë kriter duke siguruar laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me PC, videoprojektorë, programe profesionale, softeware-t Windows 10, MS TEAMS; paketa e plote Microsoft Office 365: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj., sistemin MOODLE (UET LMS).</p>

	<i>(Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Aneks 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.	<p>Praktika profesionale për programet Master i Shkencave ka 12 kredite; pra një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca), 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj).</p> <p>Institucioni garanton mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale për këtë program studimi janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me një sërë institucionesh publike dhe private.</p> <p>Studentët praktikën profesionale e zhvillojnë në mjediset e institucioneve me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Sa i takon orëve në auditor, institucioni garanton mjedise të përshtatshme, salla leksionesh me të gjitha mjetet e nevojshme.</p> <p><i>(Aneks 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Aneks 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta)</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon se program i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” zhvillohet në një infrastrukturë dhe mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafi akademik.</i></p> <p><i>Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor që i dedikohen këtij program studimi, janë të paisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike që mundësojnë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Studentët dhe stafi akademik i këtij programi kanë qasje në të gjitha mjediset dhe mjetet e teknologjike e didaktike që i shërbejnë objektivave formues të programit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



				X
--	--	--	--	---

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Studentët kanë në dispozicion literaturën e detyrueshme dhe atë shtesë. Literatura e përdorur konstatohet që është bashkëkohre. Biblioteka e institucionit, për Fakultetin e Ekonomise, Biznesit dhe Zhvillimit ka një fond prej 1708 artikujsh. <i>Aneks 0. RVB_MSH Administrim Biznesi_akreditim periodik;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit akademik, programet mësimore i nështrohet procesit të rishikimit me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë. Ky proces përfshin në radhë të parë departamentet si njësitë bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit. Departamenti inicion vendimin për rishikimin e kurrikulës dhe përditësimin e programeve të lëndëve. Njësia përgjegjëse komunikon me Përgjegjësin e Bibliotekës për përditësimin dhe pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturën e nevojshme.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Akresi në bibliotekë mundësohet për të gjithë studentët. Biblioteka ka një hapësirë dhe organizim të përshtatshëm që mundëson përdorimin në kushte optimale. Në kuadrin e të drejtave të tyre, studentët kanë të drejtën të përdorin infrastrukturën që Universiteti vë në dispozicion të procesit mësimor si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që institucioni ofron. Në këtë kuadër, ata kanë të drejtën e përdorimit në mënyrë të barabartë të mjediseve të bibliotekës dhe çdo shërbimi tjetër që ofrohet për realizimin e programit të studimit. <i>(Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond	Salla e bibliotekës që ofron institucioni ka përmasa fizike 40 m <sup>2</sup> dhe salla e leximit 50 m <sup>2</sup> me 41 vende leximi. Biblioteka është e

<p>fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>organizuar me raftë të hapura ku e gjithë literatura është e ekspozuar.</p> <p>Nga pikëpamja infrastrukturore biblioteka është e pajisur me tavolina leximi dhe PC. Për Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit disponon një fond prej 1708 artikujsh. Në përbërje të fondit fizik të bibliotekës gjenden zhanre të ndryshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Po ashtu studentët biblioteka mundëson aksesin në biblioteka online SAGE dhe EBSCO, ne te cilat eshte abonuar institucioni. Po ashtu institucioni ka aprovuar aksesin me 5 platforma elektronike të reja: Edward Elgar Publishing 2, ASTM Compass 2, IOP Science, IOP Science 2, Hein Online's Social Justice Suite.</p> <p><i>(Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi, institucioni ka mundësuar akses në bibliotekë për të gjithë studentët e këtij programi. Shfrytëzimi i burimeve të bibliotekës, si i literaturës në gjuhë shqipe apo në gjuhë të huaj mundësohet në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Personeli përgjegjës garanton mundësinë e shfrytëzimit të burimeve të bibliotekës, pa dallim nga të gjithë studentët.</p> <p><i>(Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me tavolina studimi, PC si dhe programe kompjuterike që lejon aksesin në biblioteka online SAGE dhe EBSCO, po ashtu institucioni ka aprovuar aksesin me 5 platforma elektronike të reja: Edward Elgar Publishing 2, ASTM Compass 2, IOP Science, IOP Science 2, Hein Online's Social Justice Suite.</p> <p><i>(Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,</p>	<p>Biblioteka është e aksesueshme me orare të gjata për t'u përshtatur me interesat e studentëve. Orari i bibliotekës për ditët e Hënë-Prete është 9.00-20.00 dhe për ditën e Shtunë është 10.00-17.00. Kurse gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur.</p> <p><i>(Aneks 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</i></p>

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Përgjegjësi i bibliotekës ndjek dhe raporton për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online. Fondi fizik dhe ai on-line i bibliotekës përditësohen dhe pasurohen në vijë me literaturë bashkëkohore. Blerja e librave të rinj realizohet kryesisht në bazë të kërkesave që vijnë nga Departamentet në funksion të nevojës për përditësimin dhe pasurimin e literaturës së programeve të studimit			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni administron dhe menaxhon të dhënat e studentëve nëpërmjet një sistemi efikas të menaxhimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për arkivimin e çdo dokumenti dhe të dhëna që i referohet studentëve dhe procesit mësimor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen dhe administrimin e regjistrave. Të dhënat e studenteve, përveç se në regjister, regjistrohen dhe në Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (UMIS). Të dhënat personale plotësohen dhe përditesohen edhe në version elektronik.</p> <p>Nga verifikimi GVJ në Sekretarinë Mësimore u konstatua se regjistrat administrohen në përputhje me rregullimet e parashikura në legjislacionin në fuqi. Pranë Sekretarisë Mësimore referuar këtij program studimi, administrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Regjistri themeltar i studentëve ku pasqyrohen të dhënat e studentëve në përputhje me kriteret ligjore;</li> <li>● Regjistri i arritjeve akademike i cili pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit;</li> <li>● Regjistri i të diplomuarve që përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit;</li> </ul> <p>Studentët informohen lidhur me procesin mësimor përmes sistemit UMIS dhe LMS.</p> <p><i>(Aneks 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.;</i>  <i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.;</i> <i>Aneks UET LMS Guide per pedagogun.;</i> <i>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet.;</i> <i>Aneks 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMSLSM)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Personeli i institucionit ka akses në të gjitha materialet e nevojshme pasi në PC kanë një dosje të përbashkët me emërtimin "Dokumenta UET". Kjo databazë nuk menaxhohet nga ndonjë sistem i brendshëm, por është regjistruar në Pc. Përsa i përket aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik në sistemin UET LMS, aty integrohen të dhëna në lidhje me veprimtarinë mësimore.</p> <p><i>(Aneks 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.;</i>  <i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.;</i> <i>Aneks UET LMS Guide per pedagogun.;</i> <i>Aneks</i></p>

	<p>46.3. UET LMS Guide per studentet.; Aneks</p> <p>46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit është i strukturuar në mënyrë që të ofrojë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Në kuadër të dixhitalizimit të mëtejshëm të procesit të mësimdhënies, UET u vjen në ndihmë studentëve dhe pedagogeve të saj për lehtësimin e procesit mësimor duke përdorur aplikacionin e ri mobile UET LMS. Ky kanal i posaçëm ofron akses në informacione dhe dokumente.</p> <p>Personeli po ashtu ka akses në folderin "Dokumenta UET" po ashtu edhe në UET LMS. Studentët kanë akses në UET LMS. Studentët kanë të dhëna personale për aksesin në sistemet e elektronike të universitetit. Në kontekstin e aksesit të dedikuar, sistemi siguron nivelin e duhur të privatësisë dhe sigurisë për të mbrojtur të dhënat dhe informacionet e ndjeshme.</p> <p>(Aneks 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.;</p> <p>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.; Aneks UET LMS Guide per pedagogun.; Aneks</p> <p>46.3. UET LMS Guide per studentet.; Aneks</p> <p>46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sikurse konstatuar nga GVJ, UET ka në përdorim një sistem të avancuar teknologjik dhe informatik nëpërmjet të cilit mundësohen shkëmbime të informacionit dhe komunikimit interaktiv dhe në kohë reale midis stafit akademik, atij administrative dhe studentëve në UET LMS dhe Microsoft TEAMS. Institucioni përdor sistemin LMS me anë të të cilit aksesohen on-line materialet që i reforohen programeve mësimore. Studentët dhe stafi akademik mund ta aksesojnë sistemin LMS nëpërmjet logimit me adresat zyrtare të emailit.</p> <p>(Aneks 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.;</p> <p>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.; Aneks UET LMS Guide per pedagogun.; Aneks</p> <p>46.3. UET LMS Guide per studentet.; Aneks</p> <p>46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS)</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Aktivizimi dhe aksesit i personelit në UET LMS apo TEAMS monitorohet dhe raportohet çdo semester, në kuadër të mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit mësimor. Gjatë pandemisë Covid përmes këtij sistemi monitorohej dhe vlersohej mësimi online. Përdoruesit e sistemit mund të marrin raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale. Nëpërmjet monitorimit dhe raportimeve në kohë reale, sigurohet siguria dhe privatësia e të dhënave për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm dhe të respektohet privata e individëve.</p> <p><i>(Aneks 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.;</i>  <i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.;</i> <i>Aneks UET LMS Guide per pedagogun.;</i> <i>Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet.;</i> <i>Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVI konstaton se institucioni përdor disa kanale komunikimi publike për publikimin e informacionit që lidhen me programin e studimit, si website zyrtar dhe rrjetet e tij sociale. Website zyrtar i UET është <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a></p> <p>UET ka një praktikë të publikimit të informacioneve relevante në faqen e internetit. Kjo faqe pasqyron informacionin dhe veprimtarinë e institucionit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Seksionet kryesore përfshijnë STUDIO NË UET; STAFI AKADEMIK; TË REJAT; KËRKIMI SHKENCOR; PROJEKTE DHE PARTNERË; RRETH UET</p> <p>Kjo faqe është e strukturuar mirë dhe lehtësisht e përdorshme për të filtruar dhe marrë informacionin e kërkuar.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET administron dhe menaxhon të dhënat që i referohen këtij program studimi nëpërmjet një sitsemi efikas të menaxhimit. Ky sistem mundëson administrimin dhe monitorimin në kohë reale të informacionit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në këtë program studimi.</i></p> <p><i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma të dedikuara për shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve si mënyra më e mirë për ritjen e aksesit në informacion.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				<b>X</b>
--	--	--	--	----------

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni ka një qasje të strukturuar dhe transparente në menaxhimin financiar të programit të studimit, duke siguruar raporte dhe plane të përqendruara në sigurimin e burimeve të nevojshme për një funksionim të qëndrueshëm dhe cilësor të programit. Çdo muaj bëhet një bilanc i të ardhurave dhe shpenzimet. Raporti financiar përmban një plan të qartë për mbështetjen financiare të nevojshme për të siguruar që programi i studimit të ketë burime të mjaftueshme për të funksionuar në mënyrë efektive. Ky plan përfshin burime buxhetore, burime të huaja, dhe strategjitë për rritjen e financimit në të ardhmen.</p> <p>Kryesisht financimi vjen nga tarifat e shkollimit, më pas nga grantet që alokohen në kuadër të projekteve fituese në programe të ndryshme. Çdo vit kryhet dhe auditimi financiar (shqyrtimi i sistemeve dhe procedurave të kontrollit të brendshëm për të vlerësuar efikasitetin dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të zvogëluar rrezikun financiar; Hulumtimi i llogarive financiare për të siguruar saktësinë e të dhënave dhe për të identifikuar çdo shqetësim ose anomali në situatën financiare, etj)</p> <p><i>(Aneks 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1).; Aneks</i></p> <p><i>50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).; Aneks</i></p> <p><i>50.1. Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.; Aneks</i></p> <p><i>50.2. Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.; Aneks</i></p> <p><i>50.3. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.; Aneks</i></p> <p><i>50.4. Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.; Aneks</i></p> <p><i>50.5. Raport auditimi viti 2018.; Aneks</i></p>

	<p>50.6. Raport auditimi viti 2019.;Aneks 50.7. Raport auditimi viti 2020)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni pasqyron gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregulimet ligjore. Detyrimi për pasqyrimin e gjendjes financiare të institucionit për çdo program studimi është një detyrim statutor.</p> <p>Në planin e financimit pasqyrohen detaje që i referohen ndarjes së burimeve financiare në formën e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Të ardhurat që i referohen programit të studimit gjenerohen nga tarifat e shkollimit, por edhe nga kontratat që rrjedhin nga veprimtaria kërkimore dhe grantet e përfituara.</p> <p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online. Plani financiar siguron një pamje të plotë të resurseve financiare të nevojshme për të mbështetur realizimin e programit të studimit dhe për të siguruar një mjedis të përshtatshëm mësimor për studentët. Në këtë mënyrë, përfshirja e të gjitha këtyre elementëve siguron një përfaqësim të integruar dhe të kujdesshme ndaj aspekteve të ndryshme të funksionimit të njësisë bazë përgjegjëse.</p> <p><i>(Aneks 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale; Aneks 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1).; Aneks 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).; Aneks</i></p> <p><i>50.1. Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.;Aneks</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një praktikë të kryerjes së auditimit periodik, vlerësimit dhe dokumentimit të gjendjes së financimit dhe efektivitetit financiar të tij. Kjo përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha llogarive financiare, transaksioneve, dhe dokumentacionit të lidhur. Institucioni dokumenton gjendjen e financimit, duke përfshirë burimet dhe shpenzimet. Kjo përfshin analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe identifikimin e burimeve të financimit të mundshme. Vlerësohet se sa efektivisht janë përdorur burimet financiare. Kjo përfshin krahasimin e shpenzimeve me arritjet</p>



	<p>dhe rezultatet e planifikuara, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të efektivitetit. Pas vlerësimit, institucioni harton një raport të detajuar që përmban rezultatet e auditimit, vlerësimin e gjendjes së financimit dhe efektivitetit financiar. Në bazë të rezultateve të auditimit, institucioni harton plane të veprimit për të adresuar çdo shqetësim të zbuluar dhe për të përmirësuar përgjithësisht efektivitetin financiar.</p> <p><i>(Aneks50.5. Raport auditimi viti 2018.;Aneks 50.6. Raport auditimi viti 2019.;Aneks 50.7. Raport auditimi viti 2020)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni paraqet çdo fillim viti gjendjen financiare të tij lidhur me programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka ngritur struktura të dedikuara të planifikimit, manxhimit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë financiare me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregullimet ligjore. Ai zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm të veprimtarisë financiare.</i></p>

	<i>Institucioni harton raporte financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare në nivel institucional ku përfshihen edhe planet e financimit të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje janë të rëndësishme për sigurimin e një mjedisi të drejtë dhe efikas për të gjithë pjesëmarrësit. Këto politika dhe procedura janë të përcaktuara qartësisht në aktet rregullatore të UET, në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare përkatëse. Këto politika po ashtu janë në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit të lartë. Në rregulloret e brendshme ka parashikime që mbulojnë të gjithë ciklin akademik, procesin dhe komponentët e mësimdhënies si dhe diplomimin. Këto procedura janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me parimet e institucionit si dhe strategjitë institucionale të zhvillimit. Të gjitha procedurat janë publike dhe transparente, ku studenti mund të njihet me to përmes faqes zyrtare të webit, guidave të studetit, broshurave, flyers, postera etj.</p> <p><i>Aneks 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale;</i></p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p>

	<p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 14. Kurrikula e programit MSH Administrim Biznesi;</i>  <i>Aneks 14.2. Plani mësimor i programit - MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me parimet themelore të drejtësisë dhe barazisë në fushën e arsimit, politikat dhe procedurat që institucioni akademik përcakton nga hyrja në dalje janë projektuar me qëllim që të sigurojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve në programin e studimit Master në Administrim Biznes janë transparente dhe bëhen të njohura publikisht. Respektimi me rigorozitet i këtyre rregullimeve nga strukturat e institucionit dhe personeli akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin këtë program.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>UET publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit. Kjo bën procesin e pranimit të transparent dhe i jep mundësi të gjithë kandidatëve të kenë një kuptim të qartë rreth kriterëve që do të aplikohen dhe mënyrës së vlerësimit. Bashkëpunimi me strukturat e përgjegjshme për zbatimin e maturës shtetërore gjithashtu kontribuon në integritetin dhe objektivitetin e procesit të pranimit.</p> <p>Njësia bazë mund të përcaktojë kriteret specifike pranimit, të cilat shpallen dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MAS. Në rastin e programit në fjalë Master i Shkencave në Administrim Biznes, njësia bazë nuk ka përcaktuar kriteret shtesë përveç atyre të parashikuara në legjislacion. Në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznes pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj, të cilët:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. kanë përfunduar studimet në një i) program studimi të ciklit të parë;</li> <li>b. dëshmojnë njohjen e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht ose</li> </ol>

	<p>spanjisht) përmes testeve të njohura ndërkombëtare, konform përcaktimeve me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;</p> <p><i>(Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Gjuha e përdorur është e qartë, mesazhi është i kuptueshëm dhe nuk është evaziv apo ambigüe. Aktet rregullative të institucionit i kanë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat. I gjithë informacioni që lidhet me programin e studimit është lehtësisht i aksesueshëm nga publiku përmes: website, rrjeteve sociale, materialeve promovionale, takime informuese me student, biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve; Javët e regjistrimit, etj.</p> <p><i>(Ankes 5. Rregullore e UET)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Praktika e informimit të publikut dhe të interesuarve për kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit para fillimit të çdo viti akademik është një hap i rëndësishëm që UET ndërmerr. Përpara fillimit të vitit akademik organizohen javët e regjistrimit, aktivitete informuese mbi programin e studimit. Këto janë ditë orientuese ku të nteresuuarit njihen me komponentët e programit të studimit por edhe me aspektet organizative dhe administrative që i referohen programit.</p> <p><i>(Aneks 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni parashikon për çdo vit akademik kuota specifike për përzgjedhjen e kandidateve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kjo është një përpjekje e rëndësishme për të siguruar që të gjithë studentët, pavarësisht nga karakteristikat e tyre të veçanta, kanë mundësinë e barabartë për t'u përfshirë në programet e studimit.</p>

<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Bazuar në aktet rregullative, institucioni pranon studentë të huaj që përmbushin kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>UET ka një sistem të bursave që ofron për target grupe të caktuara, si ato të shtresave në nevojë apo për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Krahas bursave, UET aplikon gjithashtu zbritje deri në 25% të tarifës referencë, në varësi të notës mesatare të maturës dhe të pagesave të menjëhershme për të gjithë ciklin e studimit, gjithashtu ofron edhe mundësinë e pagesës me këste.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se UET harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Praktika e ofrimit të informacionit të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin është një aspekt i rëndësishëm i transparencës dhe komunikimit, e cila ndihmon studentët të kuptojnë se si vlerësohet dhe monitorohet performanca e tyre akademike. Në aktet e veta rregullative UET ka të përcaktuar qartësisht notat minimale, pjesëmarrjen, procedurat e vlerësimit dhe rishikimit; informacion rreth kriterëve dhe kërkesave për kalimin nga një nivele në tjetren; kalendaret akademike, etj.

	<p><i>(Aneks 5. Rregullore e UET; Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, në aktet e brendshme rregullatore, përcaktohet se UET pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit parashikon kushtet dhe procedurat e transferimit të studimeve, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi. Informacioni është i qartë dhe lëhtësisht i aksesueshëm. Studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit.</p> <p><i>(Aneks 5. Rregullore e UET; Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UET ofron informacion që ndihmon studentët të orientohen në mënyrë më të mirë dhe të përgatiten për sukses akademik. Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara qartësisht procedurat e vlerësimit të dijës, provimet, riprovimet, bartja, përmirësimet. Përmes këtij informacioni studentëve u jepet një kuptim i qartë se si do të vlerësohet performanca e tyre dhe çfarë pritet nga ta gjatë studimeve. Kjo ndihmon në krijimin e një mjedisi të drejtë dhe përkrahës, duke i nxitur ata të përgatiten më mirë për sfidat akademike dhe të punojnë drejt suksesit.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë objekt i rregullimit në aktet e brendshme të UET. Rregulloret përkatëse si rregullorja e institucionit si dhe rregullorja që i referohet këtij programi studimi, parashikojnë procedurat, kushtet dhe kriteret që lidhen me punimin e diplomës, përzgjedhjen e temave, afatet e dorëzimit si dhe vlerësimin. Aspektet rregulluese përfshijnë edhe procesin e diplomimit. Parashikime të tilla janë edhe pjesë e dokumentave informuese që iu dedikohen studentëve.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UET ka praktikë publikimin e udhëzuesve të posaçëm dhe organizimit të takimeve të hapura për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm para fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike. Institucioni organizon një sërë aktivitetet me objek informimin e studentëve të ardhshëm, të tilla si “ditë të hapura”, “Javët e regjistrimit”. Ky proces siguron që të gjithë ata që janë të interesuar për të studiuar në institucionin e caktuar kanë një informacion të detajuar dhe të përditësuar.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se UET ofron informacion të qartë, të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit në Master i Shkencave në Administrim Biznes.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Kohëzgjatja e studimeve, struktura e programit të studimit është përcaktuar qartësisht në rregulloren mësimore të programit. Studentëve ky informacion u bëhet i ditur nga një sërë kanalesh komunikimi dhe informuese si website, rrjete sociale, mazeriale promocionale dhe informuese, aktivitete informuese, takime dhe biseda verbal, etj.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Ky kriter zabtohet me rigorozitet. Dokumenta si kurríkula e programit apo edhe rregullorja e programit të studimit kanë të përcaktuar qartësisht informacionin për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve gjendet informacion mbi përmbajtjen e lëndëve, objektivat formues si dhe format e vlerësimit të njohurive. Programet e lëndëve publikohen në website zyrtar të universitetit. UET ka në përdorim një sistem të avancuar nëpërmjet të cilit mundësohen shkëmbime të informacionit dhe komunikimit interaktiv dhe në kohë reale midis stafit akademik, atij administrative dhe studentëve në UET LMS dhe Microsoft TEAMS. Në LMS informacioni për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese aksesohet në kohë reale dhe në distance.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore e UET;</i></p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MSH Administrim Biznesi (shqip);</i></p> <p><i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi mundësitë e punësimit dhe tregun e punës. Ky suport u vjen nga njësia bazë si edhe nga zyra e Këshillimit të Karrierës. Gjatë studimeve, studentëve u ofrohet mbështetje dhe këshilla për mundësitë e zhvillimit të karrierës së tyre, si për punësim/praktikë, ashtu edhe për mundësitë e studimeve të ardhshme. Këshilltarët e karrierës i ndihmojnë studentët të identifikojnë se ku të aplikojnë dhe të përgatisin aplikimet e tyre përkatëse. Aktivitete si panairi i punës, HR clubs, leksione mbi shkrimin e cv dhe letrave të motivimit, open days, leksione mbi</p>



	<p>intervistat për punësim, ndihmojnë studentët në orietimin në karrierë.</p> <p><i>Aneks 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, Sekretaria mësimore por edhe sistemi UET LMS, bëjnë të mundur që studentëve tu garantohet informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Studentët mund ta aksesojnë këtë informacion që në momentin e parë të regjistrimit, nëpërmjet veprimtarive orientuese apo informuese që organizon institucioni.</p> <p><i>(Aneks 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UET LMS është një sistem për menaxhimin e mësimdhënies që ju lejon studentëve aksesimin e materialeve. Secili student disponon një llogari personale dhe e akseson këtë sistem po ashtu online në distancë.</p> <p><i>(Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.; Aneks 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Aneks 46.3. UET LMS Guide per studentet.; Aneks 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni është angazhuar dhe ka ndërmarrë hapa konkrete në informimin e studentëve në të gjitha aspektet e jetës studentore.</i></p> <p><i>Studentët kanë akses të plotë në informacionin mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe informimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																					
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të monitorimit dhe raportimit të performancës së programit të studimit, institucioni mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Kjo siguron një bazë të qartë të të dhënave dhe mundëson institucionin të monitorojë zhvillimin e programit dhe të marrë vendime bazuar në të dhënat konkrete. Zyra e zhvillimit të karrierës dhe Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ecurinë e tyre të punësimit. Zyra e Alumni fillon gjurmimin e brezave që kanë përfunduar studimet, 6 muaj pas diplomimit të tyre, përmes kontakteve kryesisht: telefonikë, email, pyetësor. Mbështetur në (Evidencën nr. 27 Cilësia në hyrje dhe dalje për programin) rezultoni se numri i studentëve të regjistruar në katër vite akademike për këtë program është:</p>																																																					
<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1048 746 1182">Viti akademik</th> <th data-bbox="746 1048 962 1182">Programi/profili</th> <th data-bbox="962 1048 1117 1182">Te regjistruar për herë të parë</th> <th data-bbox="1117 1048 1272 1182">Të transferuar</th> <th data-bbox="1272 1048 1394 1182">Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1182 746 1417" rowspan="3">19-20</td> <td data-bbox="746 1182 962 1249">Menaxhim Marketingu</td> <td data-bbox="962 1182 1117 1249">32</td> <td data-bbox="1117 1182 1272 1249">2</td> <td data-bbox="1272 1182 1394 1249">34</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1249 962 1317">Administrim Publik</td> <td data-bbox="962 1249 1117 1317">11</td> <td data-bbox="1117 1249 1272 1317">2</td> <td data-bbox="1272 1249 1394 1317">13</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1317 962 1417">Menaxhim dhe vlerësim Projektsh</td> <td data-bbox="962 1317 1117 1417">8</td> <td data-bbox="1117 1317 1272 1417">3</td> <td data-bbox="1272 1317 1394 1417">11</td> </tr> <tr> <td data-bbox="592 1417 746 1653" rowspan="3">20-21</td> <td data-bbox="746 1417 962 1485">Menaxhim Marketingu</td> <td data-bbox="962 1417 1117 1485">34</td> <td data-bbox="1117 1417 1272 1485">5</td> <td data-bbox="1272 1417 1394 1485">39</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1485 962 1552">Administrim Publik</td> <td data-bbox="962 1485 1117 1552">7</td> <td data-bbox="1117 1485 1272 1552">7</td> <td data-bbox="1272 1485 1394 1552">14</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1552 962 1653">Menaxhim dhe vlerësim Projektsh</td> <td data-bbox="962 1552 1117 1653">7</td> <td data-bbox="1117 1552 1272 1653">2</td> <td data-bbox="1272 1552 1394 1653">9</td> </tr> <tr> <td data-bbox="592 1653 746 1888" rowspan="3">21-22</td> <td data-bbox="746 1653 962 1720">Menaxhim Marketingu</td> <td data-bbox="962 1653 1117 1720">24</td> <td data-bbox="1117 1653 1272 1720">2</td> <td data-bbox="1272 1653 1394 1720">26</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1720 962 1787">Administrim Publik</td> <td data-bbox="962 1720 1117 1787">8</td> <td data-bbox="1117 1720 1272 1787">2</td> <td data-bbox="1272 1720 1394 1787">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="746 1787 962 1888">Menaxhim dhe vlerësim Projektsh</td> <td data-bbox="962 1787 1117 1888">4</td> <td data-bbox="1117 1787 1272 1888">5</td> <td data-bbox="1272 1787 1394 1888">9</td> </tr> <tr> <td data-bbox="592 1888 746 1948">22-23</td> <td data-bbox="746 1888 962 1948">Menaxhim Marketingu</td> <td data-bbox="962 1888 1117 1948">24</td> <td data-bbox="1117 1888 1272 1948">1</td> <td data-bbox="1272 1888 1394 1948">25</td> </tr> </tbody> </table>						Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali	19-20	Menaxhim Marketingu	32	2	34	Administrim Publik	11	2	13	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	8	3	11	20-21	Menaxhim Marketingu	34	5	39	Administrim Publik	7	7	14	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	7	2	9	21-22	Menaxhim Marketingu	24	2	26	Administrim Publik	8	2	10	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	4	5	9	22-23	Menaxhim Marketingu	24	1	25
Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali																																																		
19-20	Menaxhim Marketingu	32	2	34																																																		
	Administrim Publik	11	2	13																																																		
	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	8	3	11																																																		
20-21	Menaxhim Marketingu	34	5	39																																																		
	Administrim Publik	7	7	14																																																		
	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	7	2	9																																																		
21-22	Menaxhim Marketingu	24	2	26																																																		
	Administrim Publik	8	2	10																																																		
	Menaxhim dhe vlerësim Projektsh	4	5	9																																																		
22-23	Menaxhim Marketingu	24	1	25																																																		

		Administrim Publik	7	1	8
		Menaxhim dhe vlerësim Projektesh	21	3	24
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës ruan të dhëna të plota mbi studentët në databazën e tij elektronike. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit (UMS), regjistrohen dhe ruhen të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, ndjekja e ecurisë akademike të studentëve, kalueshmëria, mesatarja e notës, etj. Po ashtu institucioni disponon informacion tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p><i>Aneks 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.;</i></p> <p><i>Aneks 27. Cilesia ne hyrje dhe ne dalje per programin MSH Administrim Biznesi;</i></p> <p><i>Aneks 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore)</i></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format fizik, por edhe elektronik. Ky informacion administrohet nga strukturat kompetente në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Informacioni është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe Sekretarinë mësimore pa nga afër proceset e administrimit të regjistrave dhe mori disa raste për kontroll të saktësisë së mirëmbajtjes.</p>				

<p>përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ ju bë e ditur se institucioni realizon kontrole periodike pranë sekretarisë mësimore por edhe pranë strukturave të tjera përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e brendshëm të informacionit në lidhje me studentët dhe procesin mësimor.</p>																																																						
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Kjo njësi asistohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (dhe Alumni).</p> <p>Përmes analizave të tilla, institucioni mund të bëjë ndryshime të nevojshme për të siguruar një përvojë më të mirë dhe një përgatitje më të mirë të studentëve për tregun e punës. Në vijim statistika mbi shkallën e punësimit të të diplomuarëve:</p> <p>Statistika për punësimin e studentëve të diplomuar:</p> <table border="1" data-bbox="606 1064 1394 1870"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th rowspan="2">Cikli i studimeve/fakulteti/programi</th> <th rowspan="2">Të diplomuar</th> <th colspan="2">Të punësuar</th> <th rowspan="2">Shkalla e punësimit në %</th> <th rowspan="2">Papunë</th> <th rowspan="2">Vazhdojnë studime</th> </tr> <tr> <th>Total</th> <th>Në përputhje me diplomën</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">18-19</td> <td>Master</td> <td>336</td> <td>106</td> <td>90</td> <td>32</td> <td>18</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit</td> <td>195</td> <td>67</td> <td>56</td> <td>34</td> <td>8</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Administrim Biznesi (MSH)</td> <td>36</td> <td>10</td> <td>7</td> <td>28</td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td rowspan="3">19-20</td> <td>Master</td> <td>719</td> <td>235</td> <td>182</td> <td>29</td> <td>94</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit</td> <td>335</td> <td>109</td> <td>88</td> <td>29</td> <td>20</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Administrim Biznesi (MSH)</td> <td>38</td> <td>17</td> <td>15</td> <td>42</td> <td>1</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Cikli i studimeve/fakulteti/programi	Të diplomuar	Të punësuar		Shkalla e punësimit në %	Papunë	Vazhdojnë studime	Total	Në përputhje me diplomën	18-19	Master	336	106	90	32	18	1	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	195	67	56	34	8	1	Administrim Biznesi (MSH)	36	10	7	28	1		19-20	Master	719	235	182	29	94	2	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	335	109	88	29	20		Administrim Biznesi (MSH)	38	17	15	42	1	
Viti	Cikli i studimeve/fakulteti/programi				Të diplomuar	Të punësuar				Shkalla e punësimit në %	Papunë		Vazhdojnë studime																																										
		Total	Në përputhje me diplomën																																																				
18-19	Master	336	106	90	32	18	1																																																
	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	195	67	56	34	8	1																																																
	Administrim Biznesi (MSH)	36	10	7	28	1																																																	
19-20	Master	719	235	182	29	94	2																																																
	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	335	109	88	29	20																																																	
	Administrim Biznesi (MSH)	38	17	15	42	1																																																	

	20-21	Master	627	219	194	35	10	4	304	51
		Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	264	115		44	32	1	116	56
		Administrim Biznesi (MSH)	51	24	23	47	2		25	51
<i>(Aneks 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tab.23)</i>										
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky kriter përmbushet plotësisht, pasi institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>									
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
				<b>X</b>						

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i UET parashikon të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset e vendimarrjes së Universitetit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Studentët organizohen në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor si edhe dy studentë të tjerë janë anëtarë të Senatit Akademik. Po ashtu studentët gjejnë përfaqësim në struktura të tjera vendimmarrëse Dekanat, Këshillin e Etikës, dhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.  <i>(Aneks 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e	Studentët përfaqësohen në organet më të rëndësishëm vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në jetën institucionale dhe

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>proceset vendimmarrëse, siguron një mjedis më demokratik dhe transparent. Përcaktimi i këtyre të drejtave ndihmon në ndërtimin e një kulture ku opinioni dhe kontributi i studentëve janë të vlerësuar dhe të integruar në proceset vendimmarrëse të universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve me studentët diskutoi mbi angazhimin e tyre në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Studentët ftohen në mbledhjet e hapura në njësinë bazë për të shprehur idetë dhe mendimet e tyre në kuadër të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Statuti ka sanksionuar të drejtën e studentëve të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik, gjë e cila realizohet përmes pyetësorëve. Vlerësimi i performancës së pedagogëve dhe stafit ndihmës akademik realizohet në disa forma, 2 herë në vit realizohet pyetësori me studentët, në fund të secilit 86im und86.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e brendshme të institucionit dhe të programit të studimit sanksionojnë të drejtën e studentëve të shprehin qëndrimin e tyre mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentet kanë të drejtën të shprehen në lidhje me procedurën si dhe shkallën e vlerësimit të dijeve të tyre nëpërmjet procesit të ankimimit dhe kërkesës për rivlerësim. Rregullorja sanksionon se në rast se 86im und ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës 86im und t'I drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, ngrihet një Komision I përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të</i></p>

	<i>përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka njësi të posaçme si Sekretaria mësimore, Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Po ashtu infrastruktura teknologjike përmes sistemit LMS bën të mundur informimin në kohë reale të studentëve. <i>Aneks 2. Statuti UET_ struktura organizative aktuale;</i> <i>Aneks 5. Rregullore e UET</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se një sërë strukturash ndihmës akademike dhe jo vetëm, janë ngritur në funksion të informimit, këshillimit dhe asistimit të studentëve lidhur me programin e studimit. Ndër këto struktura përmendim Zyra e pranimeve; Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, Keshilluesit Akademik, Sekretaria Mësimore, kordinatorët e departamenteve, regjistruarit e lendeve, etj të gjithë janë në dispozicion të plotë të studentëve për tu shërbyer dhe mbështetur.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mundëson për studentët këshillim dhe orientim gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit mësimor. Kjo zyrë ofron shërbime të ndryshme për të ndihmuar studentët në zhvillimin e tyre profesional dhe përgatitjen për tregun e punës si edhe i ndihmon ata në identifikimin e objektivave në aspektin e punësimit dhe ofron mbështetje për të arritur ato.

<p>posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>(Aneks 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (dhe Alumni) gjurmon studentët pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin se sa integrohen në tregun e punës.</p> <p>Nëse i referohemi statistikave të vëna në dispozicion konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-për vitin akademik 2018-2019 shkalla e punësimit ishte në normën 28%;</li> <li>-për vitin akademik 2018-2020 shkalla e punësimit ishte në normën 42%;</li> <li>-për vitin akademik 2020-2021 shkalla e punësimit ishte në normën 47%;</li> </ul> <p>Këto statistika iu vihen në dispozicion autoriteteve drejtuese për të marrë masat dhe planet e veprimit.</p> <p><i>Aneks 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tab.23)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT



**Standardi VI.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Zhvillimi i vullshëm i teknologjisë së informacionit gjatë viteve të fundit ka ndikuar dhe në metodat e mësimdhënies. UET në fillim të vitit akademik harton një plan veprimesh mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p>Trajnimit e personelit akademik për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies drejt atyre më inovative është një nga prioritetet e UET. Krahas trajnimit të personelit akademik institucioni përshkruan si një tjetër alternativë për pasurimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, edhe angazhimin e personelit akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike e cila do t'i mundësojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Institucioni, ka aktiv një sistem të menaxhimit të performancës për personelin akademik, i cili thjeshtëson procesin e identifikimit të personelit akademik që përdor metoda të vjetra mësimdhënieje dhe që duhet të përfitojë nga kualifikimet përditësuese në mësimdhënie.</p> <p><i>Aneks 30.9 Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset;</i> <i>Aneks 37 Format i relacionit për monitorimin e silabuseve,</i> <i>Aneks 30.10 Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UET i ofron studentëve një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh. Staf i pedagogjik dhe studentët zhvillojnë aftësitë dhe idetë e tyre dhe përbushin përgjegjësitë e tyre duke përdorur kompetencat akademike, arsyetimin dhe qytetarinë e dëshiruar. Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar dhe zyrtarizuar në Planin Strategjik të UET 2021-2025. Në këtë dokument janë të përshkruara politika dhe procedurat që do të ndjekë institucioni gjatë gjithë kësaj periudhe. Institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën</p>

	<p>mësimore dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij.</p> <p>Një praktikë e vazhdueshme në këtë institucion dhe më specifikiht në Departamentin e menaxhimit dhe Marketingut, është asistimi nga pedagogët e rinj në leksione të zhvilluara nga Profesorë dhe titullarë modulesh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, me qëllim përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Në zbatim të planit të veprimtarive të saj UET organizon leksione të hapura nga personalitete në fushën akademike dhe nga biznesi. Informacioni i transmetuar i shërben stafit akademik për përmirësimin e materialeve mësimore dhe studentëve për zhvillimin e njohurive të tyre.</p> <p>Vlerësimi i performancës së pedagogëve dhe stafit ndihmës akademik realizohet në disa forma. 2 herë në vit realizohet pyetëtori me studentët, në fund të secilit semestër. Gjithashtu Dekani apo Shefi i departamentit bëjnë vlerësime periodike për stafin akademik. Vlerësimi bazohet nga kontrollet e realizuar gjatë procesit mësimor, puna në grup, kualifikimi i tyre, angazhimi në kërkim dhe projekte si dhe nga anketimi i studentëve. Në mënyrë të përvitshme realizon analizën e punës mësimore, ku një nga rubrikat kryesore që trajtohet është mësimdhënia dhe vlerësimi i performancës së pedagogëve në mësimdhënie.</p> <p><i>Aneks 2 Statuti UET;</i></p> <p><i>Aneks 41 G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Një mekanizëm që u përmend dhe më sipër është dhe anketimi periodik i studentëve në fund të çdo semestri mësimor. Në këto anketime studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies të stafit akademik dhe lëndët e frekuentuara në atë semestër mësimor. Zyra e Sigurimit të Cilësisë analizojnë rezultatet e anketimit dhe rezultatet degohen në departamente dhe tek stafi i përfshirë. Përsa i përket vlerësimit të dijeve nuk përjashtohet mundësia e përmirësimit të notës dhe e ankimit të studentëve dhe trajtimi i ankimit jepet në rregulloren e Fakultetit.</p> <p><i>(Aneks 40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</i></p>

	<i>Aneks 5 Rregullore UET, Aneks 2 Statuti UET;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>KSBC është struktura përgjegjëse e ngritur pranë UET për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Sektori i Sigurimit të Cilësisë është pjesë e strukturës së kësaj drejtorie dhe merret me hartimin e standardeve për realizimin e procesit mësimor. Rezultatet e anketimit të studentëve bëhen publike nga strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) nëpërmjet analizës vjetore të njësisë. Ato diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.</p> <p>Në rastet e problematikave të ngritura nga ana e studentëve, pas analizimit në mbledhje departamenti është munduar të adresohet edhe zgjidhja e tyre rast pas rasti. Gjatë takimeve të realizuara në institucion u dhanë disa shembuj konkretë kur janë marë masa në raste ankesash të vazhduara nga ana e studentëve.</p> <p><i>Aneks 40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</i></p> <p><i>Aneks 8 Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ”);</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UET është angazhuar në politikat integruese të personelit akademik, duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit si dhe përfshirjen në projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore.</p> <p>Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në kuadër të marrveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit dhe riintegrimi i tyre në rradhët e personelit akademik ka qenë dhe mbetet një kërkesë për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të ekspertizës së UET.</p>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlereson se Universiteti European i Tiranës ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Ndjekja e gjithë proceseve mesimore me focus cilesine ne mesim ndiqen nga zyrat perkatese ne perputhje me rreguloret e IAL. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përmbushje të akteve ligjore në fuqi, UET ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit planin sigurimit të cilësisë zë një vend të vecantë. Për sigurimin e cilësisë UET, aplikon Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë, të orientuara në Strategjitë, politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, aprovimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve të studimit, vlerësimi i studentëve, sigurimi i cilësisë së stafit akademik, burimet e të nxëniet dhe përkrahja e studentëve, sistemet informative, etj.”.</p> <p>Strukturat e ngritura dhe përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë, Zyra e Standarteve dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore si dhe Zyra e Kurrikulave. Zyra e Standarteve dhe Cilësisë (ZSC) në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në nivel fakulteti dhe universiteti organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë të përzgjedhur nga asambleja e personelit akademik si dhe me përfaqësues nga asambleja e studentëve. Gjithashtu bazuar në dokumentin Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për periudhën 2017-2022 si dhe bazuar në strategjinë e re 2023-2028, UET specifikon tërësinë e politikave, strukturave dhe procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është një dokument në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Në të përfshihen parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë, proceset dhe mekanizmat e monitorimit,</p>

	<p>vlërësimin të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e shërbimeve për studentët në UET.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET, Aneks 30.3.1 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022;</i></p> <p><i>Aneks 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UET është ngritur Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Përbërja e KSBC është, Kryetari i Komisionit, dy përfaqësues lektorë në secilin Fakultet, një përfaqësues nga stafi administrativ, dy përfaqësues nga Këshilli Studentor, si dhe të paktën një përfaqësues që është ekspert i jashtëm.</p> <p>Gjatë takimit me studentët u bë e qartë përfshirja a tyre në këtë proces nëpërmjet të qenit pjesë e KSBC, pjesëmarrjes në fokus grupe, pjesëmarrjes në vlerësimin online në platformën UET-LMS në çdo moment duke komunikuar me stafin e UET, si dhe duke iu ofruar mundësia e trajtimit të ankimeve të tyre. Përfshirja e studentëve realizohet gjithashtu nëpërmjet një formulari, i cili mundëson që studentët të shprehin mendimet e tyre për padagogët dhe për ndonjë problematikë të mundëshme.</p> <p>Përfshirja e ekspertëve të jashtëm konsiderohet e rëndësishme në terma të objektivitetit dhe paanshmërisë gjithashtu edhe për të sjellë pikëpamje dhe perspektiva të ndryshme nga ato ekzituese brenda institucionit duke mundësuar në këtë mënyrë përmirësimin e praktikave që implementohen.</p> <p><i>Aneks 5 Rregullore UET;</i></p> <p><i>Aneks 30.3.1 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022;</i></p> <p><i>Aneks 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet</p>	<p>Institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë i nënshtrohen vlerësimin fillestar, vlerësimin periodik dhe vlerësimin krahasues. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë në UET është realizuar përmes proceseve të vlerësimin të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. UET i</p>

<p>përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>është nënshtruar akreditimit institucional për herë të parë në 2017 si dhe akreditimeve të programeve të studimit. Për këtë program studimi akreditimi i mëparshëm është realizuar me sukses në vitin 2018.</p> <p><i>Aneks 54.3 UMAS Nr.246, datë 24.07.2009 "Për akreditimin Institucional të UET";</i></p> <p><i>Aneks 54.1 VBA Nr. 12 datë 07.04.2017 "Për akreditimin institucional të UET";</i></p> <p><i>Aneks54.4 UMASR Nr. 527, datë 04.09.2018 "Për riorganizimin e Fakultetit Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit"</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Për vlerësimin e cilësisë së procesit përfshihen treguesit relevant të cilësisë që lidhen me programet e studimit, procesin mësimor, stafin akademik, studentët, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë mbështetëse, etj në përputhje me standardet e cilësisë të përcaktuara në dokumentat strategjike të UET. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet nëpërmjet analizave periodike, dhe nëpërmjet anketimit të studentëve.</p> <p>KSBC organizon monitorimin dhe vlerësimin për secilin nga proceset akademike gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj.</p> <p><i>Aneks 30.9 Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset;</i></p> <p><i>Aneks 30.10 Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve,</i> <i>Aneks 30.7.8 Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shpreh mendimin se UET harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UET ka pjesë të praktikës së punës së saj përdorimin e metodologjive dhe instrumentave matëse dhe vlerësuese për mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit. Instrumentat përfshijnë tërheqjen e mendimit nga stafi akademik i përfshirë në program në lidhje me problemet dhe zgjidhjet e mundëshme; tërheqjen e mendimi të studentëve nëpërmjet pyetësorëve dhe diskutimi në mbledhjet e departamentit; dhe aktorë publikë me të cilët UET ka marrëveshje.</p> <p>Rëndësi e posaçme i kushtohet përshtatjes së kurrikulës në përputhje me dinamikën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në terësi dhe atë të tregut në veçanti për specialistë në fushat e ofruara nga programi i studimit. Procedura e ndjekur për ndryshimin e kurrikulës fillon me propozimin nga departamenti që ofron programin përkatës të studimit, i cili kërkon miratimin e fakultetit. Fakulteti pasi miraton kurrikulën e re, të propozuar nga departamenti, e dërgon për miratim në strukturat e rektoratit.</p> <p>Gjatë këtij rishikimi vëmendje i kushtohet elementëve përbërës të moduleve, kreditet, bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, literaturës së përdorur, procedurave të kontrollit të dijeve/ provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit.</p> <p><i>(Aneks 30.6 Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim</p>	<p>UET, Fakulteti dhe Departamenti përkatës hartojnë raportin e analizës vjetore të mësimit dhe punës kërkimore shkencore ku përfshihet performanca e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj, qoftë atë mësues apo kërkues si dhe formimi profesional i studentëve.</p> <p>Raporti përmban jo vetëm arritjet (nëpërmjet statistikave e fakteve mbi realizimin e procesit mësues e shkencor) por edhe ngre shqetësime e problematika duke analizuar shkaqet e tyre si</p>

<p>të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>dhe duke propozuar masa konkrete për përmirësimet e nevojshme. Në fillim të cdo viti akademik, në bashkëpunim me departamentet, KSBC harton dhe miraton planin e aktiviteteve për përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p><i>Aneks 30.6 Format_Raporti për Provimet;</i></p> <p><i>Aneks 38 Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në çdo vlerësim ka një metodologji të qartë të saj që i referohet standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë kuadër vlerësohen të gjitha raportet e analizave mësimore dhe kërkimore, të cilat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Programet e studimit:</li> <li>▪ Procesi mësimor</li> <li>▪ Stafit akademik</li> <li>▪ Studentët</li> <li>▪ Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm</li> </ul> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet nëpërmjet analizave periodike, të asistuarit në orën e mësimit (leksione apo seminare) dhe nëpërmjet anketimit të studentëve.</p> <p>Veprimtaria monitoruese e KSBC përfshin aktivitete për:</p> <p>Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi (realizimi i procesit mësimor dhe marrja e mendimit të studentëve, përdorimi i sistemit të menaxhimit mësimor LMS, monitorime nga KSBC)</p> <p>Kërkimi shkencor (ngritjen e grupit Ad-Hoc për kërkimin dhe metodologjinë e personelit akademik, krijimi i grupeve kërkimore, kërkimet individuale të personelit akademik)</p> <p>Mbështetja e studentëve (monitorimi i hyrjeve/daljeve të studentëve, punësimi i të diplomuarve, lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe subjekte).</p> <p>Sigurimi i Cilësisë (rishikimi i rregulloreve të UET dhe programit të studimit, zhvillimi i analizës SWOT, vlerësimi i burimeve njerëzore dhe mjedisit, notat, zhvillimi i testeve të ndërmjetme, përgatitja e syllabuseve, hartimi dhe shpallja e</p>



	<p>detyrave, trajnimi për standardet e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë).</p> <p><i>Aneks 30.8 G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu;</i></p> <p><i>Aneks 30.1 Plani i veprimit KSBC;</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të ndryshme vlerësimi si sondazhe të studentëve, intervista në panairin e karrierës, anketime nga të diplomuar në UET për të vlerësuar performancën e programit të studimit.</p> <p>Për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit të ri akademik dhe stafit ndihmës akademik, drejtuesi i departamentit plotëson formularin e performancës çdo vit akademik, duke u mbështetur në informacionin e grumbulluar nga kontrollet e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta mbi aktivitetin e tyre.</p> <p>UET ka pjesë të strukturave të saj konsultative edhe bordin e alumnit si një organ konsultativ për përmirësimet kurrikulare dhe jo vetëm. UET ka lidhur shumë marrëveshje me biznese dhe insitucione për realizimin e praktikave profesionale dhe për të përmirësuar procesin e krijimit të kopetencave profesionale të gjithë atyre që ndjekin studimet në çdo program të UET.</p> <p>Vetë pedagogët zhvillojnë bashkëbisedime me studentët për të evidentuar në se ka ndonjë problematikë apo kërkesë nga ana e tyre për përmirësimin cilësor të mësimdhënies.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mendon se UET ka ngritur dhe operon me struktura qe monitorojne dhe vlerësojne në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Roli i strukturave akademike dhe administrative lidhur me sigurimin e cilësisë përcaktohet në Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në të specifikohen funksionet e të gjitha strukturave që nga Senati e deri tek pedagogët. Studentët marrin pjesë në jetën administrative e UET përmes anëtarësisë së zgjedhur në Senat, përfshirja në komisionet e akreditimit, etj. Studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor. Ata kanë të drejtë të vlerësojnë dhe ofrojnë mendimet e tyre përmes anketimit që realizohet rregullisht dy herë përgjatë vitit akademik.</p> <p>Vetë pedagogët dhe stafi ndihmës janë pjesë e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në mbledhjet e departamentit dhe të asamblesë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë;</i>  <i>Aneks 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë, Vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në Statutin e UET dhe rregulloren e Fakultetit janë mirëpërcaktuar detyrat dhe modalitetet e angazhimit të strukturave të ndryshme të të gjitha niveleve në proceset e vlerësimit të cilësisë. Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përshkruan organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në lidhje me parimet, qëllimin, objektivat, strukturat përbërëse, përgjegjësitë, detyrat, trajnimet, angazhimin e studentëve dhe palëve të tjera.</p> <p>Në planin e veprimit të KSBC, janë përcaktuar qartë detyrat, dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri tek pedagogët e thjeshtë. Një sërë detyrash brënda këtij plani masash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.</p>

	<p><i>Aneks 30.1. Plani veprimit KSBC;</i></p> <p><i>Aneks 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë;</i></p> <p><i>Aneks 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë pranë UET së bashku me të gjitha strukturat e tjerat të institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit formalizohet nëpërmjet përgatitjes së raporteve të analizës vjetore, formateve të performancës, përpunimit të të dhënave nga anketimet, etj. Të gjithë antarët e personelit janë aktivë në diskutimin e këtyre dokumentave në mbledhjet e Departamentit. Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet angazhimit në plotësimin e pyetësorëve periodikë.</p> <p><i>(Aneks 30.1. Plani veprimit KSBC)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është i angazhuar të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Realizimi i anketimeve me studentët në nivel njësie bazë për programin e studimeve është tregues i qartë i përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në procese ciklike si të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve, pikërisht duke dhënë shembullin e shmangies së diskriminimit apo pabarazisë. Çdo pyetësor ka një format të caktuar që respekton etikën, standardet profesionale dhe ai miratohet paraprakisht në çdo strukturë drejtuese në UET. Ai respekton anonimatën e studentëve dhe çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Pyetjet janë të tilla që as nuk diskriminojnë e as nuk përjashtojnë elementët e procesit akademik dhe stafet përkatëse. Nga ana tjetër të gjitha formatet e vlerësimit të performancës dhe cilësisë janë të diskutuara dhe miratuara paraprakisht.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit bashkëpunon intensivisht me aktorët e biznesit si edhe strukturat e tjera publike dhe private duke u përpjekur ti involvojë ata në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programit të studimit. Bashkëpunimi është konkretizuar në organizimin e leksioneve me personalitet të ftuara, panairët e</p>

që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	punësimit, në ofrimin e mjediseve për praktika profesionale të studentëve, etj. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta me qëllim kryesor përmirësimin e mundshëm të kurrikules apo programeve të veçanta të moduleve, që të përmbushin më së miri nevojat e punëdhënësve potencialë. Në nivel institucional, UET ka marrëveshje bashkëpunimi për praktikat mësimore me këta aktorë.  <i>Aneks 34. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit_UET;</i> <i>Aneks 12.2. Poster Panairi i Punës 2018_2019_2021_2022)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shpreh mendimin se UET përfshin në menyre aktive njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e sigurimit te cilesise. Gjithashtu te gjitha palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre informohen ne kohe reale. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti European i Tiranës ka parashikuar politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet më të rëndësishëm të tij të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit.  Këto dokumente janë Statuti i UET, Rregullorja e Studimeve Universitare të UET, Strategjitë e ndryshme. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit, në

	<p>përputhje me rregulloren e tij dhe planin e veprimit të miratuar. Kuadri rregullator i UET parashikon publikimin në faqen zyrtare të veprimtarive përfshirë dhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p><i>Aneks 2 Statuti i UET; Aneks 7 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", <a href="https://uet.edu.al/rreth-uet">https://uet.edu.al/rreth-uet</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit që janë pjesë integrale e Analizave të Veprimtarive Mësimore e Kërkimore Shkencore të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut dhe Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, diskutohen në nivel departamenti, në të cilën merren masat për përmirësimin e dobësive. Pjesë e kësaj analize janë edhe rezultatet e anketave të studentëve. Niveli i transparencës në bërjen publike të tyre merr parasysh parimet e etikës dhe ligjin për mbrojtjen e të drejtave personale.</p> <p><i>(Aneks 16. A.II. Kodi i Etikës)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në bashkëpunim me departamentet, adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga proceset e vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit në vitin paraardhës. Rezultatet e vlerësimit të KSBC shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë plotësimin e mangësive dhe reduktimin apo eliminimin e dobësive të evidentuara, për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë. Në fillim të çdo viti akademik harton dhe miraton planin e veprimit, me qëllim përmirësimin e ecurisë së programeve të studimit për vitin e ri akademik.</p> <p><i>(Aneks 30.3.1 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së institucionit, kurrikulës, procesit mësimor, pedagogëve, studentëve, realizohet në mënyre periodike dhe më pas merren masat e nevojshme për përmirësim në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Raportet e veprimtarisë së Departamentit dhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përmbajnë jo vetëm analizën e ecurisë dhe arritjet por gjithashtu japin dhe rekomandimet përkatëse për përmirësime të nevojshme. Stafet angazhohen për</p>

	<p>plotësimin e rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë. Analiza periodike jep mundësinë e vlerësimit së efektivitetit të masave të ndërmara dhe mundësinë e rregullimit të mënyrës së veprimit apo rritjes së efektivitetit të masave.</p> <p><i>(Aneks 43.1 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit – DMM)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat drejtuese të UET dhe Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ndër vite kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asambleve akademike për çështje që kanë të bëjnë më të gjithë veprimtarinë e IAL-së, ku një vend të rëndësishëm zë diskutimi për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>UET dhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përmes pyetësorëve ndërgjegjëson studentët dhe në mbledhjet e saj informon stafin mbi arritjet, mungesat dhe problematikat lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore.</p> <p>Institucioni ka të zyrtarizuar Planin Strategjik të UET, në të cilin janë të përshkruara politika dhe procedura që do të ndjeke institucioni gjatë gjithë kësaj periudhe.</p> <p><i>(Aneks 3. Plani Strategjik UET 2021-2025, <a href="https://uet.edu.al/en/asambleja-e-pedagogëve-uet-shoqëria-duhet-ti-rikthehet-normalitetit/">https://uet.edu.al/en/asambleja-e-pedagogëve-uet-shoqëria-duhet-ti-rikthehet-normalitetit/</a>)</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shpreh qendrimin se te gjithe proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit jane publike dhe transparente. Nga vrojtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet e realizuara u vu re se stafi dhe studentet ishin teresisht te njohur me kete procedura. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile “Menaxhim Marketingu”, “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, në përputhje me objektivat formuese si edhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve;
2. Programi siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, dhe aktorë të biznesit;
3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi, duke ofruar një program studimi të detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje, që garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin;
4. Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit;
5. Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët;
6. Burimet Njerëzore, Infrastruktura, Logjistika për Realizimin e Programit të Studimit përmbushin standardet për ofrimin e një programi studimi cilësor;
7. Institucioni ka qasje ndaj studentit, duke ofruar mbështetje në të gjitha aspektet e procesit mësimor dhe jetës studentore.

**b. Pika të dobta:**

1. Mungesa e trajnimeve profesionale për të diplomuarit; (*Standardi I.2, Kriteri 5*)
2. Përfshirje e ulët e studentëve në projekte apo aktivitete kërkimore shkencore; (*Standardi II.6, Kriteri 3*) (*Standardi II.7, Kriteri 2*)
3. Mungesa e ofrimit të programit si program i përbashkët me IAL të huaja; (*Standardi II.1, Kriteri 9*)

**Rekomandime**

1. GVJ rekomandon kritere më të forta në rekrutimin e stafit akademik si dhe ndërmarjen e politikaqë nga IAL që të garantojnë një qëndrueshmëri të stafit në kohe;

2. GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
3. Më shumë angazhim në orgaizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar;
4. Rekomandohet fuqimisht të vihet në dispozicion një grant i veçantë në mbështetje të veprimtarisë kërkimore shkencore;
5. Të zhvillohen më shumë iniciativa dhe të zgjerohet gama e aktiviteteve ku të përfshihen studentët në studime, projekte apo aktivitete kërkimore shkencore;
6. Angazhim më i madh në role koordinimi i personelit akademik të njësisë bazë në projekte kërkimore shkencore dhe rritja e përpjekjeve të tyre në hartimin, aplikimin e projekt propozimeve;
7. Intensifikim i përpjekjeve për ofrimin e programit si program i përbashkët me IAL të huaja;

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Business Administration" with profiles "Marketing Management", "Public Administration", "Project Management and Evaluation"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. This Study program is in accordance with its mission and purpose, which aims to preserve national interests and values, and is organized in accordance with the national legal and by-law provisions in force and internal regulatory acts, in accordance with the educational objectives as well as the level of qualification according to National and European Framework of Qualifications;
2. The program ensures cooperative relations with institutions, companies, third parties, and business actors;
3. The main/base unit responsible for the study program fulfills the legal requirements and quality standards for these units, offering a detailed, informative, structured and organized study program in accordance, which guarantees the learning process and professional and scientific training with the best methods and practices, centered on the students;
4. The institution draws up regulations and special procedures for testing, evaluation of knowledge, professional and scientific skills, fair and transparent evaluation, based on the merit of each student, including the appeal process;
5. The study program guarantees the growth of creative and application skills among students;



6. Human Resources, Infrastructure, Logistics for the Implementation of the Study Program meet the standards for providing a quality study program;
7. The institution is student-oriented, offering support in all aspects of the learning process and student life;

**b. Weaknesses:**

1. Lack of professional training for graduates; (*Standardi I.2, Kriteri 5*)
2. Low involvement of students in scientific research projects or activities; (*Standardi II.6, Kriteri 3*) (*Standardi II.7, Kriteri 2*)
3. Lack of offering the program as a joint program with foreign HEIs (*Standardi II.1, Kriteri 9*)

**Recommendation**

1. External Evaluation Group recommends stronger criteria in the recruitment of academic staff as well as the initiation of policies by HEIs to guarantee a stability of the staff over time;
2. External Evaluation Group recommends that the necessary measures be taken to enable the academic personnel with a contract engaged in the realization of the study program to have at least the scientific degree Doctor of Science, in order to fulfill the legal requirements in force, for the appropriate level of qualification academic;
3. More engagement in the organization of further professional training for graduate students;
4. It is strongly recommended to make available a special grant in support of scientific research activity;
5. To develop more initiatives and expand the range of activities where students are involved in studies, projects or scientific research activities;
6. Greater engagement in coordinating roles of the academic staff of the basic unit in scientific research projects and increasing their efforts in the design and application of project proposals;
7. Intensification of efforts to offer the program as a joint program with foreign HEIs;

**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X